

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7585 E mërkurë 11 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Gjithnjë e më shpesh dëgjojmë të flitet për "sundimin e ligjit, apo shtetin ligjor" sikurse dhe për "shtetin e të drejtës". Ka shumë botime dhe janë ...  
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Shteti i së drejtës  
apo sundim me ligje?



Opinion

Ditës

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

Në Shqipëri të dhënat e grumbulluara nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, i cili mbikëqyr dhe ndihmon procesin e rivlerësimit të gjykatësve ...  
Vijon në faqen 21

Thanza i hetuar për korrupsion,  
pikëpyetje mbi integritetin e tij



Kryeministri: Negociatat? 12 muaj punë

## Pakti detar, Rama takon Cipras: Së shpejti do kemi zgjidhje pozitive

Bushati: Ka rezistencë politike në Shqipëri e Greqi, janë kundër perspektivës europiane

DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama dhe homologu i tij grek, Aleksis Cipras u takuan dje, në Londër, në kuadër të Samitit të Ballkanit Perëndimor. Burimet zyrtare thanë për mediat se dy kryeministrit diskutuan rreth negociatave ...  
Në faqen 5

## SKANDALI/ VETINGU: ADMIR THANZA, 40 DITE BURG NGA GJYKATA E PIZES

# ANETARI I GJYKATES SE LARTE, I DENUAR PER VJEDHJE NE GRUP

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit: Thanza e fshehu vendimin në formularin e dekriminalizimit. PD: Presidenti Meta ta shkarkojë gjyqtarin



(Në foto) Gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Admir Thanza, gjatë një seance të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK

Në faqen 3

AKTORET

Protestuesit e Teatrit akuzohen për vjedhje: Janë shpifje kundër nesh

Në faqen 18

TATIMET

Skema e TVSH, Vjero: Respektoni afatet për deklarimin ose keni penaltete

Në faqen 8

EMRAT E PERFITUESVE

Pronat në Korçë, ATP-ja merr në shqyrtim 10 mijë dosje, lista e re

Në faqen 10-11

KONKURSI SHKENCOR

Akademia shpall nominimet për veprat mbi Skënderbeun

Në faqen 19

VIP Pages

Velina e "Stop": Unë me fotoshop? Përgjigjen e merrni çdo mbrëmje

## Alesia Bami: Kush është mashkulli im ideal

Enca u bën surpriza djemve. Këshilla, si t'i shijoni pushimet pa strese

Nga PAMELA ALIAJ

Ku do t'i kaloni pushimet këtë verë? S'e kam menduar ende, por sigurisht brenda dhe jashtë vendit tonë. Keni ndonjë projekt të fundit pas pjesëmarrjes si velinë të "Stopi"? Tashmë është



periudhë pushimesh, më pas do të flas për projektet në vazhdim. Sa e vështirë është të jesh një modele? Po është e vështirë, por dhe shumë e bukur. Për sa kohë mendoni se do të vazhdoni hobin tuaj? Si e sheh veten Alesia në të ardhmen? Do e ...  
Suplement

Suplement

DOKUMENTET



Pensioni familjar, formulari dhe kategoritë që e përfitojnë

Në faqen 9

## VETINGU SKANDALI

Komisioni "kryqëzon" kandidatin e KLP se mbylli çështjen e gjyqtarit Thanza

# Vetingu për prokurorin Kristaq Beluri, KPK: S'ka probleme me pasurinë

## "Nuk ka kryer deklarim të rremë"

TIRANË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit zhvilloi pasditen e djeshme një seancë dëgjimore me prokurorin Kristaq Beluri. Ai është përbërur me KPK, si pjesë e listës prioritare për shkak të kandidimit të tij si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Trupa gjyqësore, e cila përbëhet nga Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici ka lexuar raportin për prokurorin Beluri, që sipas ILDKP rezultoi se ka kryer deklarim të saktë dhe justifikon pasurinë dhe burimet financiare. Mësohet se për Belurin janë kryer hetime në të tria kriteret: Pasurinë, aftësitë profesionale dhe integritetin e figurës. Gjatë fjalës së saj, reatorja Bekteshi deklaroi se, "ILDKPI ka raportuar se Beluri ka bërë deklarim të saktë dhe ka burime të mjaftueshme financiare. Prokurori nuk gjendet në konflikt interesi dhe zotëron një apartament 63 m<sup>2</sup> dhe depozitë bankare 850 mijë lekë. Ndërsa, përse u përket aftësive profesionale, KPK tha se Kostaq Beluri ka pushuar çështjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Admir Thanzës (akuzohet për korruption) dy vite më parë. Ky i fundit rrezikon të mos e kalojë procesin e vetingut. Në përballjen e djeshme në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ka dalë ndër të tjera që gjyqtari Thanza ka marrë para nga një i afërm i një personi me probleme me drejtësinë. Në seancë është shfaqur një foto e gjyqtarit Thanza me motrën e një personazhi të njohur në Shkodër (zyrtar i hipotekës). Sipas përgjimeve të forcës operationale, në një moment gjatë takimit, shihet teksa këmbëjnë një pako me gruan në fjalë, pra e merr pakon nga njëra qese, e kalon në tjetrën. Për këtë arsye edhe prokurori Kostaq Beluri do të shqyrtohet për këtë çështje, pasi nuk ka kryer hetime të thelluara. Aktualisht Kostaq Beluri punon si prokuror në Sektorin e Verifikimit të Integritetit, i njohur ndryshe si sektori i



Prokurori Kostaq Beluri

Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Ai ka punuar si zvpokurore i Tiranës në vitet 1999-2004 dhe si drejtor i Luftës kundër Krimit të Organizuar në Policinë e Shtetit në vitet 2004-

2007. Më pas, Beluri është rikthyer sërish në organin e akuzës si zvdrejtor i Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe prej vitit 2014 ushtron detyrën në Prokurorinë e Përgjithshme.

### MBYLLI ÇËSHËTJEN E GJYQTARIT

Sipas KPK, prokurori Kostaq Beluri e justifikon pasurinë. Ndërsa, përse u përket aftësive profesionale, KPK tha se Beluri ka pushuar çështjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Admir Thanzës (akuzohet për korruption) dy vite më parë. Në përballjen e djeshme në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ka dalë ndër të tjera që gjyqtari Thanza ka marrë para nga një i afërm i një personi me probleme me drejtësinë. Për këtë arsye prokurori Kostaq Beluri do të shqyrtohet për këtë çështje, pasi nuk ka kryer hetime të thelluara.

### PASURIA

Analiza e pasurisë është një ndër tri shtyllat e rivlerësimit për gjyqtarët, së bashku me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Të dhënat e anali-



Seanca e djeshme dëgjimore për prokurorin Beluri

zuara nga BIRN tregojnë se prokurori Kostaq Beluri zotëronte pasuri familjare në vlerën e 1.3 milionë lekëve në vitin 2003, kur deklaroi pasurinë për herë të parë. Në fund të vitit 2017, pasuria familjare e zotit Beluri kap vlerën e 5.2 milionë lekëve. Beluri zotëron një apartament banimi 70 m<sup>2</sup> me vlerë 1.1 milionë lekë dhe 1/5 e një apartamenti të përfutur nga familja përmes privatizimeve, pasuri këto të deklaruara prej vitit 2003. Ai zotëron gjithashtu 2.9 milionë lekë llogari bankare dhe 1.2 milionë lekë kursime në cash. Të ardhurat familjare të prokurorit Beluri kapin vlerën e

33.8 milionë lekëve për vitet 2003-2017. Ato përbëhen në 97 për qind nga të ardhurat e pagës së tij dhe të bashkëshortes, 2.4 për qind nga interesat bankare dhe 0.3 për qind nga mësimdhënia.

Përveç analizës për rritjen/uljen e pasurisë, strukturën e asetëve dhe të ardhurave, ky raport paraqet dhe kontrollin aritmetik/logjik të deklaramenteve të subjektit si dhe "flamujt e kuq", që identifikohen gjatë kontrollit. BIRN kreu kontrollin aritmetik/logjik mbi 14 vite të deklaruara të zotit Beluri dhe asnjëra prej tyre nuk rezultoi me probleme.

## Ankimuan vendimin e Markut për pezullimin nga detyra

### "Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë", Strasburgu pranon shqyrtimin e çështjes së dy prokurorëve

TIRANË - Prokurorët Rovena Gashi dhe Dritan Gina e kanë zhvendosur betejën e tyre ligjore me Prokuroren e Përgjithshme, Arta Marku, për KPK, KPA apo ONM në gjykatën e Strasburgut. Mësohet se kjo gjykatë ka pranuar të marrë në shqyrtim, nëpërmjet procedurës së njoftimit urgjent të autoriteteve shqiptare dhe kalimit në seancë gjyqësore me prioritet, ankimin e prokurorëve Gashi dhe Gina, duke e regjistruar çështjen e tyre me nr:29943/18 "Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë", dt. 27.06.2018. Çifti i prokurorëve ka ankimuar një seri procedurash ligjore, të ndjekura nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

### KËRKESA

Pas konfirmimit se çështja do të shqyrtohet nga Gjykata e Strasburgut, prokurorja Rovena Gashi kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të martën, dt. 10.07.2018, të ndërprejë procedurën e rivlerësimit kalimtar të nisur ndaj saj. Këtë kërkesë e bazon në përcaktimet e neneve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

it, përfshirë edhe Kolegjin e Posaçëm të Apelitit dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit si edhe të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm.

Ata kërkojnë nga Gjykata e Strasburgut që të shqyrtojë shkeljet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, të kryera nga KPK, KPA dhe Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm, duke vendosur rrezimin

e kërkesës për pezullimin e tyre nga detyra, si edhe të konstatojë shkeljet procedurale gjatë procesit të rivlerësimit. Pas konfirmimit se çështja do të shqyrtohet nga Gjykata e Strasburgut, prokurorja Rovena Gashi kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të martën, dt. 10.07.2018, të ndërprejë procedurën e rivlerësimit kalimtar të nisur ndaj saj. Këtë kërkesë e bazon në përcak-



timet e neneve 17, 29, 32, 34, 38 dhe 46 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në bazë të të cilave autoritetet e brendshme nuk mund të vijojnë shqyrtimin e çështjes, përse kohë procedurave para-praktike të saj po shqyrtohen nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut deri në vendimin përfundimtar prej saj. Dy prokurorët Rovena Gashi dhe Dritan Gina në aplikimin e tyre i kanë argumentuar Gjykatës së Strasburgut se institucionet kanë dështuar që t'u sigurojnë një proces të rregullt ligjor si gjatë procesit të rivlerësimit,

ashtu edhe në procesin penal. Në kërkesën e regjistruar tashmë në Gjykatën e Strasburgut, aplikantët pretendojnë se në procedurat e ndjekura nga Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA), konstatohen shkeljet, si vijon:

a-mohimin flagrant të vendimit përfundimtar prej saj. Dy prokurorët Rovena Gashi dhe Dritan Gina në aplikimin e tyre i kanë argumentuar Gjykatës së Strasburgut se institucionet kanë dështuar që t'u sigurojnë një proces të rregullt ligjor si gjatë procesit të rivlerësimit,

b-shkeljen e së drejtës për të respektuar jetën private, për shkak të pezullimit të menjëhershëm, të paligjshëm dhe arbitrar.





## VLERESIMI PROFESIONAL

13 denoncime  
në KPK kundër  
gjyqtarit  
Admir Thanza

Përsa i përket vlerësimit të kriterit profesional gjyqtari Thanza ka pasur probleme. Në 5 dosjet e zgjedhura me short dhe të vlerësuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë janë konstatuar mungesa e 3 procesverbale të dhomës së këshillimit dhe mangësi të tjera. Por megjithë problemet e konstatuara, KLD ka dhënë një vlerësim të përgjithshëm pozitiv për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Reporter.al shkruan se në KPK kundër gjyqtarit Thanza kanë ardhur 13 denoncime, të cilat përtej indijëve nuk janë marrë në konsideratë. Por duke u fokusuar tek çështja e etikës profesionale dhe integriteti, relatori Komici saktësoi se gjyqtari Thanza nuk kishte deklaruar në vitin 2017, dhuratën e një garazhi nga kompania Curri Sh.p.k. e cila kishte qenë palë në një çështje në Gjykatën e Lartë në shkurt 2018 ku Thanza ka qenë relator. Sipas KPK-së gjyqtari Thanza nuk e ka përmendur këtë dhuratë, e cila është konfirmuar edhe nga dëshmia e noterit. Në përgjigjen e tij ndaj gjetjeve të hetimit administrativ, gjyqtari Thanza u ndalua tek kriteri i pasurisë ku kontestoi disa nga llogaritjet e bëra nga ekspertit financiar i KPK-së në lidhje me shpenzimet e tij jetike, si për shembull për vitin 1993-1994 kur ai nuk kishte qenë i martuar. "Nuk njoh bashkjetesën por vetëm martesën ligjore sepse jam konservator," i tha Thanza komisionit.

Vetingu/ Admir Thanza nuk e raportoi faktin në formularin e dekriminalizimit

# Skandali, gjykatësi i Lartë i dënua për vjedhje në bashkëpunim në Itali

ONM: 40 ditë burg nga gjykata e Pizës në vitin 1999



Admir Thanza, anëtar i Gjykatës së Lartë

## SHKARKIMI

PD i kërkoi dje Presidentit Meta që të shkarkojë gjyqtarin Admir Thanza për fshehje të dënimit në Itali në formularin e dekriminalizimit. KPK duhet ta kishte shkarkuar gjyqtarin Thanza që në prill 2018, kur është vënë në dijeni të faktit, jo ta lejonte që ai të qëndronte në detyrë edhe 3 muaj të tjerë. PD kërkon nga prokuroria fillimin e procedimit penal ndaj gjyqtarit të lartë për shkeljen prej tij të ligjit të dekriminalizimit", shprehet PD.

Një skandal i paprecedentë ka përfshirë sistemin e drejtësisë. Procesi i vetingut ka zbuluar se Admir Thanza, anëtar i gjykatës së Lartë rezultoi i dënua në Itali për vjedhje në grup.

Dje gjyqtari Thanza u përball me gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si pjesë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për kriterin e integritetit të figurës, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka administruar raportin e Departamentit të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas të cilit subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e dekriminalizimit procedim penal për korrupsion aktiv, i cili është pushuar në vitin 2016. Sipas DSIK-së gjyqtari Thanza ose familjarë të tij kanë pasur kontakte me anëtarë të krimit të organizuar, dhe si rrjedhim është vlerësuar si i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

## DENIMI NE ITALI

"Gjithashtu, sipas informacioneve të sjella Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), gjyqtari Thanza është dënua më 40 ditë burg në vitin 1999 në Itali për vjedhje në bashkëpunim, një informacion që gjithashtu nuk është deklaruar në formularin e dekriminalizimit. Sipas KPK-së gjyqtari Thanza ka pasur dijeni për këtë vendim sepse është ndaluar në "flagrance", shkruan Reporter.al.

Në mbrojtjen e tij, gjyqtari Thanza argumentoi me ton melodramatik incidentin në Itali, ku sipas tij ai kishte marrë përsipër një vjedhje të bërë nga e kuna, për shkak se nipi i tij ishte i sëmurë dhe rrezikonte kurimin nëse nëse e ëma dënohej.

"Me sinqeritet e kam vlerësuar trupën gjyqesore dhe përfaqësuesen e ONM. Ajo që më shqetëson vërtet është procedimi penal. Kam tentuar ta shpjegoj me sinqeritet. Te jeni koshient kur në jetën time unë s'mund ta bëja një veprim të tillë. Mora përsipër dënimin për të mbrojtur një fëmijë të mitur, është djali i vëllait tim. Vjedhjen e ka bërë ish-kunata. Kurrrë nuk e dija", tha Thanza.

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë nuk dha shpjegime pse dënimin në Itali hetimin për korrupsion në Shqipëri nuk e kishte deklaruar në formularin e dekriminalizimit të vitit 2016-të. Sipas ligjit mosdeklarimi i për-

## Avokati

**INTEGRITETI I FIGURES**

Avokati Theodorri Sollaku kontestoi raportin e DSIK-së, duke argumentuar se Admir Thanza nuk kishte pasur kontakt me antarë të krimit të organizuar gjatë çështjes hetimore, por me një mik të tij që e njihje prej 20 vitesh. Më tej Sollaku shtoi se personi në fjalë ishte shpallur i pafajshëm.



plasjeve të shkaura me ligjin për zyrtarët e lartë si Thanza përbën vepër penale. Ndërkohë, Sollaku në emër të klientit pranoi dënimin në Itali të vitit 2001 në Piza, por u shpreh se Thanza kishte dhënë shpjegime në përgjigjet me shkrim dhe nuk mund të thellohej më tej për shkak se çështja përfshinte të mitur dhe të dhëna personale.

## DYSHIMI MBI PASURINE

Trupa e KPK-së përbëhej nga Olsi Komici si kryesues, Luan Hamiti relator dhe Brunilda Bekteshi antëtare, ndërsa Thanza asistoi nga avokati Theodorri Sollaku. Sipas relatorit të çështjes Luan Hamiti, Thanza është hetuar për të tre kriteret e rivlerësimit, ku përfshihet pasuria, integriteti i figurës dhe profesionalizmi.

Si pjesë e hetimit të pasurisë së gjyqtarit, KPK ka administruar raportin e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të In-

teresit, ILDKPKI, sipas të cilit gjyqtari Thanza ka bërë deklaram të pasaktë, deklarim të rremë dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme.

KPK gjithashtu ka ndër-marrë një hetim administrativ të pavarur të pasurisë së gjyqtarit dhe të personave të lidhur. Si pjesë e këtij hetimi,

Sipas KPK-së në deklaratën periodike të vitit 2003 në ILDKPKI, gjyqtari Thanza ka deklaruar blerjen e një apartamenti në vitin 2000 prej 136 m<sup>2</sup> në qytetin e Shkodrës me vlerë 3 milion lekë. Megjithatë, sipas KPK-së kontrata e shitjes së këtij apartamenti ka vlerën 1.2 milionë lekë. Komisioni ka vënë re se në dosjen e ILDKPKI-së ka pasur dy fletë deklarimi të ndryshme për këtë aset, ku në njerin vlera e asetit përshtet si 3 milion lekë dhe në tjetrin si 1.2 milionë lekë plus rikonstrukcion prej 1.8 milionë lekë. Si burim të adhurash për blerjen e apartamentit gjyqtari Thanza ka deklaruar shitjen e dy apartamenteve të tjerë (1+1 dhe 2+1), por sipas KPK-së këto apartamente nuk ishin shitur në momentin që është bërë blerja e apartamentit të tretë. KPK pretendon gjithashtu

është jo reale dhe nën çmimin mesatar për Shkodrën për vitin 2000.

Aseti i dytë i hetuar nga KPK është një apartament prej 113 m<sup>2</sup> te lagja Komuna e Parisit në Tiranë, i cili në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit si i blerë në vlerën 4 milion lekë, ndërkohë kontrata e shitblerjes me ndërtuesin ka qenë për vlerën 1.95 milion lekë. Mospërputhje janë shënuar edhe për një apartament duplex në gjirin e Lalzit, të cilit gjyqtari Thanza në vitin 2012 ka deklaruar një sipërfaqe prej 99.55 m<sup>2</sup>, ndërsa në deklaratën veting një sipërfaqe prej 38 m<sup>2</sup>. Gjithashtu në vitin 2007, subjekti nuk ka deklaruar blerjen e një garazhi të Komuna e Parisit në vlerë 400 mijë lekë, i cili është deklaruar në deklaratën veting.

Analiza financiare e të adhurave dhe shpenzimeve e kryer nga ekspertët e Komisionit gjithashtu ka zbuluar mospërputhje, duke sinjalizuar mungesë burimesh financiare gjatë viteve 1992-2003 në vlerë 2.7 milion lekë, gjatë vitit 2003 në vlerë 6.2 milion lekë, në vitin 2004 në vlerë 369 mijë lekë dhe në vitin 2005 në vlerë 842 mijë lekë. Një bilanc negativ është raportuar nga Komisioni edhe për vitet 2008 dhe 2009, respektivisht në vlerat 389 mijë lekë dhe 2.79 milion lekë.

"Familja Thanza nuk pasur të ardhura të mjaftueshme për shpenzimet jetike dhe investimet e deklaruar," u shpreh relatori Komici.

## GARAZHI

Thanza, gjithashtu, hodhi poshtë në fjalën e tij vlerësimin profesional, duke arsyetuar se "nuk është bazuar në argumenta ligjorë." Ai tha se firma Curri Sh.p.k i kishte transferuar në vitin 2017 një garazh që ai kishte në pronësi që nga viti 2000, por që nuk ishte regjistruar në Hipotekë.

mi janë hetuar origjina dhe ligjshmëria e burimeve financiare e disa pasurive të paluajtshme në Tiranë dhe Shkodër.

se të dhënat e marra nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Shkodër, tregojnë që vlera prej 1.2 milionë lekë

# SAMITI I LONDRES INTEGRIMI

Komisioneri për Zgjerimin pritet të vijë në Tiranë javën tjetër

## Negociatat, Hahn: Kalimi në qershor 2019, varet nga procesi i skanimit

### "Pakti detar, vlerësoj përpjekjet e Shqipërisë dhe Greqisë"

Komisioneri për Zgjerimin Johannes Hahn pritet të vijë javën e ardhshme në Tiranë. Vetë Komisioneri për Zgjerimin në Bashkimin Europian njoftoi vizitën e tij, gjatë fjalës që mbajti në Samitin për Ballkanin Perëndimor që zhvillohet në Londër. Kjo vizitë, e cila do të nisë nga Shkupi vjen në kuadër të një ture ballkanike që ka si qëllim sqarimin e hapave të mëtejshëm të integrimit pas rekomandimit të dhënë nga KE për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Më herët në një postim në Twitter, duke iu referuar negociatave mes Tiranës dhe Athinës për çështjen e detit, Hahn shprehej se "janë për t'u vlerësuar përpjekjet mes dy vendeve për të firmosur këtë pakt dhe për të arritur në një marrëveshje". Ndërkohë, duke folur në një takim në kuadër të samitit të Londrës, Hahn u shpreh optimist se shumë shpejt Tirana dhe Athina do t'i japin zgjidhje mosmarrëveshjeve për çështje të lëna pezull. Ai shpjegon edhe arsyet pse procesi i zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor po zgjat më shumë nga sa ishte parashikuar. "Kemi nevojë për politikanë të zotë në rajon. Kemi parë të tillë, për shembull kur vjen fjala për bisedimet për çështjen e emrit me Maqedoninë, ose me shumë gjasa nëse do të ketë një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Greqisë për ripërcaktimin e kufijve dhe kjo është vendimtare për qytetarët", u shpreh Hahn. "Disa prej shteteve të unionit janë të ashpër në veçanti pas eksperiencave që kemi pasur me anëtarësimet e reja, sepse ata kërkojnë të shohin jo thjesht përparim, por që ky përparim të jetë i pakthyeshëm. Kjo është edhe arsyeja pse negociatat e sotme dhe procesi i zgjerimit do të zgjasë më gjatë", sqaroi Hahn, në lidhje me vendimin që u mor më 28 qershor për Shqipërinë e Maqedoninë. Konferenca e Londrës është pjesë e procesit të Berlinit të nisur 4 vjet më parë. Liderët e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, partnerët të Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesit e institucioneve evropiane, u priten sot

nga kryeministria britanike, Theresa May, e cila prezantoi një pako masash për ndihmë për Ballkanin Perëndimor. Hahn ka anonçuar nga samiti i Londrës, se javën e ardhshme do të bëjë hapjen zyrtare të procesit të "skanimit" në Tiranë dhe Shkup. Procesi i skanimit

ka të bëjë nga njëra anë me ekzaminimin analitik të legjislacionit të vendeve kandidatë për të evidentuar nivelin e tyre të harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Europian. Nga ana tjetër, procesi i skanimit merret me identifikimin e fushave, ku kërkohet përpa-

rim në legjislacionin e vendeve kandidatë për të qenë në përputhje me rregullat e BE. "Detyra jonë tani është të përgatitim hapjen e negociatave vitin e ardhshëm përmes procesit të skanimit, apo një ekzaminim gjithëpërfshirës. Unë do të shkoj në Tiranë dhe në Shkup për të filluar procesin e skanimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë javën e ardhshme. Është një proces sfidues që tregon nivelin e angazhimit të këtyre vendeve për të avancuar, duke qenë se kalimi në fazën tjetër të qershorit të 2019-s varet pikërisht nga shpejtësia dhe cilësia e këtij procesi. Sa më shumë të bëhet gjatë procesit të skanimit, aq më shumë avancim do ketë për hapjen e negociatave", sqaroi Hahn. Komisioneri Hahn ka treguar në samitin e Londrës, se përfundimisht vendimi për të përcaktuar vitin 2025 si një afat indikativ për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit në BE, edhe pse është ambicioz, ka pasur efekt pozitiv.



Komisioneri për Zgjerimin Johannes Hahn

### Kukan: Raportet e mira Serbi-Shqipëri, ndikim pozitiv në rajon

## Daçiq: Marrëdhëniet me Shqipërinë të ngarkuara nga Kosova, të eliminojmë problemet

Marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Serbisë ka ndikim pozitiv në të gjithë rajonin, u shpreh europarlamentari Eduard Kukan sot në Beograd. Në fjalën e tij gjatë konferencës ndërkombëtare me temë "Sërbët dhe shqiptarët - Në cilin drejtim?", e organizuar nga agjencia serbe e lajmeve "Tanjug" në bashkëpunim me Agjencinë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Kukani nënvizoi se konferenca zhvillohet në kohën e duhur dhe rezultati i saj mund të jetë një kontribut pozitiv për të gjithë rajonin. "Nëse ekzistojnë probleme në marrëdhëniet me Serbisë dhe Shqipërisë, atëherë ekzistojnë probleme më të mëdha në rajon", shtoi ai. Kukan tha se Brukseli i percepton të këto marrëdhënie në një



kontekst rajonal. "Askush nuk ka dyshim që Serbia dhe Shqipëria janë aktorë të rëndësishëm në rajon", theksoi ai, duke shtuar që të dy vendet konsiderohen si pjesë e procesit të integrimit dhe zgjerimit të Bashkimit Europian. "Ne e dimë që është e domosdoshme që ky proces të vazhdojë," deklaroi Kukan. Nga ana e tij, ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiq tha në këtë konferencë se marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve janë të ngarkuara nga çësht-

ja e Kosovës. "Është e rëndësishme të eliminohet shkak i problemeve në marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve janë të rëndësishme për rajonin dhe për BE-në", - u shpreh Daçiq në konferencën e organizuar nga "Tanjug" dhe Agjencia Shqiptare e Lajmeve, ATSH. Askush nuk mund të përcaktojë shkaktar që sjell probleme më mirë se sa ne - mbi të gjitha, problemi qëndron të përzierja e kombeve, tha ai. "Dikush na ka trazuar dhe ka probleme në lidhje me këtë, por ka edhe avantazhe. Le të eliminojmë problemet dhe të jemi së bashku. Të gjithë ne në rajon jemi vëllezër e motra dhe nuk duhet të lejojmë që të huajt të nxinin mosmarrëveshjet mes nesh", - tha ai.



Kryeministri Edi Rama dhe në Samitin e Londrës

### ANËTARËSIMI NË 2025

"Duhet të keni parasysh, se për t'u anëtarësuar në 2025-n do të thotë që negociatat të përfundojnë në 2023 dhe ky afat është pothuajse nesër. Është ambicioz, por jam i kënaqur që e propozuam, pasi duhet të zgjidhim midis 2025 dhe 2030, por 2030 tingëllon kaq larg, sa që asnjë s'mund ta merrte si një propozim të besueshëm nga ne. Kështu që besoj se gjetëm ekuilibrin e duhur", - theksoi Hahn.



### Presidenti i PE-së përkrah diskutimin për emigrantët

## Kampet e refugjatëve, Tajani: Nuk ndërtohet asgjë pa "OK"-in e Shqipërisë

Presidenti i Parlamentit Europian, Antonio Tajani, është shprehur se asnjë kamp refugjatësh nuk do të ndërtohet në Shqipëri, në rast se nuk ka një dakordësi me Tiranën. Zyrtari i lartë i Brukselit e pranoi se është diskutuar ideja e ndërtimit të strukturave të tilla në Ballkan, por deri më tani nuk ka asnjë vendim. Gjithashtu, ai qartësoi se për të ngritur të ashtuquajturat hot spot, është e nevojshme të ketë një marrëveshje me vendet pritëse. "Është e vërtetë, që është diskutuar për ngritjen e kampeve të refugjatëve apo të platformave për të identifikuar e dalluar emigrantët nga refugjatët në korridorin e rrugës ballkanike apo në veçanti në një nga vendet ballkanike. Është e vërtetë që është folur, por nuk është marrë asnjë vendim", - tha Tajani, citon "Ora News". "Për të ngritur këto kampe apo platformat hot spot duhen bërë në sintoni me vendin ku do të ngrihen. Pra, nuk mund të ngrihen nëse nuk ka një marrëveshje me Shqipërinë apo me çdo vend tjetër goftë. Natyrisht që marrëveshja e arritur me Turqinë ndihmon në reduktimin e fluksit të emigrantëve, por, nëse është e nevojshme ne duhet të ngremë një kamp emigrantësh në një nga vendet e Ballkanit, por që duhet të vendosim se në cilin prej tyre e në marrëveshje të plotë me të", u shpreh Tajani. Sa i takon procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, Tajani nënvizoi se në këtë aspekt ka vonesë. Ai tha, gjithashtu, se personalisht ka qenë gjithmonë favorizues për procesin integrues të vendit tonë. Megjithatë, Tajani kërkoi vazhdimin e progresit për të respektuar edhe kriteret e Kopenhagenit.





Darina Tanushi

**K**ryeministri Edi Rama dhe homologu i tij grek, Aleksis Cipras u takuan dje, në Londër, në kuadër të Samitit të Ballkanit Perëndimor.

Burimet zyrtare thanë për mediat se dy kryeministrit diskutuan rreth negociatave mbi një numër të madh çështjesh, që po drejtohen nga Ministrat e Jashtëm dhe vlerësuan arritjet e deritanishme. Ndërsa në një postim të faqes së Kryeministrit në Twitter thuhet: "Ndonëse ka ende çështje që do të vazhdojnë të diskutohen nga ekipet negociatore, kryeministrit Rama dhe Cipras shprehën besimin se një zgjidhje pozitive mund të arrihet së shpejti". Rama shoqërohej në këtë takim nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtëm, Ditmir Bushati si dhe drejtori i Komunikimit në Kryeministri, Endri Fuga. Sa i takon palës greke, ra në sy mungesa e ministrit të Jashtëm, Nikos Kotzias. Kryeministri i Greqisë, Aleksis Cipras nga Londra ka deklaruar se po përpëqen që të zgjidhin problemet mes Greqisë dhe Shqipërisë. "Po përpëqemi të zgjidhim problemet midis Greqisë e Shqipërisë. Ballkani po ndryshon dhe kjo duket nga marrëveshja e Prespës dhe rigjallërimi i axhendës së Selanikut për integrimin evropian të rajonit", u shpreh Cipras. Kryeministri i Greqisë, Aleksis Cipras, nga samiti i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Londër, ka paralajmëruar nënshkrimin e shpejtë të marrëveshjes me Shqipërinë, marrëveshje e cila përfshin edhe ndarjen e kufirit detar dhe zonave ekonomike. Mediat greke citojnë një deklaratë të tij, duke e cilësuar Shqipërinë si një vend në krizë. "Evropa përjetoi përtej krizës ekonomike, krizën më të keqe të refugjatëve pas luftës, e cila u përgjendua në rajon. Ne kemi përjetuar një përpjekje të tmerrshme të grushtit të shtetit në Turqi, si dhe krizat në Shqipëri dhe Maqedoni", tha Cipras, duke vënë theksin de deklaratat e presidentit të Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker, i cili në vitin 2014 njoftoi ngrirjen e zgjerimit.

Kryeministri shqiptar Edi Rama, gjatë vizitës në Londër, ka mori pjesë në samitin për vendet e Ballkanit Perëndimor ka folur për procesin e hapjes së negociatave të Shqipërisë me BE-në gjatë vitit 2019.

Kryeministri Edi Rama në Londër. Në intervistën e dhënë IBNA dhe Albanian Free Press, Rama tha se 12 muajt e lëna nga BE do të shërbejnë si një kohë për një proces të rëndësishëm analitik. "Është një proces i vazh-

Kryeministri në Londër flet për negociatat: Do shfrytëzojmë 12 muajt, s'do rrimë asnjë minutë

# Pakti detar, Rama takon Cipras: Besim se do arrijmë zgjidhje pozitive së shpejti

Kryeministri grek: Po përpëqemi të zgjidhim problemet



Kryeministri Edi Rama dhe homologu i tij grek, Aleksis Tsipras dje, në Londër

"Ndonëse ka ende çështje që do të vazhdojnë të diskutohen nga ekipet negociatore, kryeministrit Rama dhe Tsipras shprehën besimin se një zgjidhje pozitive mund të arrihet së shpejti".

## Rama takon Ciprasin, Berisha: Ditë e zezë, i dorëzon detin dhe nderin

Ish-kryeministri Sali Berisha, tha se e marta është një ditë e zezë në historinë e kombit shqiptar pasi në takimin që Kryeministri Rama do të ketë me homologun grek, do t'i dorëzojë "detin dhe nderin". "Ditë e zezë në historinë e kombit shqiptar! Shqipëria dorëzon detin dhe nderin e saj Greqisë! Miq, sot në Londër, Jorgo Zografi i dytë, Edvin Kristaq Rama në një akt madhor të tradhtisë kombëtare së bashku me Ciprasin e Greqisë vendos: Copëtimin e ri të dytë pas vitit 1913 të trojeve shqiptare. Ne këtë copëtim, të bazuar në një marrëveshje të përgatitur nga alfa tek omega në Athinë. Greqia i merr Shqipërisë 1200 km sipërfaqe deti dhe trilionat fuçi naftë dhe metër kub gaz, pra fushat e gazit dhe të naftës më të mëdha të Mesdheut. Sipas kësaj marrëveshje, në një akt grabitqar ndaj Shqipërisë, Greqia zgjeron ujërat e saj territoriale nga 6 në 12 km ndërkohë që me dy fqinjët e tjerë, Italinë dhe Turqinë, ajo ka firmosur për vetëm 6 km", -tha Berisha. Sipas tij, "përveç kësaj, Jorgo Zografi i dytë sot në Londër tradhton, poshtëron dhe dorëzon nderin e kombit shqiptar, ai vendos që të fshijë nga faqja e dheut fjalët 'çam' dhe 'Çamëri'.

## Ministri i Jashtëm: Nuk duhet humbur më shumë kohë

### Marrëveshja e detit, Bushati: Ka rezistencë nga Greqia dhe Shqipëria

Takimi Rama-Tsipras është një mundësi e artë për të përcaktuar linjat e drejtimit që duhen të jepen në procesin e dialogut me Greqinë, deklaroi dje, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. I ndodhur në Londër, Bushati u shpreh: "Ne kemi bërë hapa të qëndrueshëm përpara për sa i përket bisedimeve për një marrëveshje të re për kufizimin e zonave detare, një marrëveshje e re që do të udhëhiqet nga parimet e të drejtës ndërkombëtare publike, në fushën e detit, por mbi të gjitha një marrëveshje e re e cila do të ishte e drejtë dhe e zbatueshme për dy vendet tona. Nuk është një proces i lehtë, ka rezistencë politike në të dyja anët, qoftë në Shqipëri, ashtu dhe në Greqi, por besojmë se me vendosmëri dhe vullnet politik të qartë, ne në një të ardhme të afërt do të kemi produktet konkrete, qoftë për këtë marrëveshje ashtu dhe për pjesën tjetër që përbëjnë elementët e paketës që ne po diskutojmë me Greqinë". Ministri tha më tej se rezistenca ka të bëjë më tepër me qëndrimet politike si në Shqipëri dhe në Greqi, duke u shprehur se segmente të caktuara ose preferojnë status quo ose janë kundër një perspektive të përbashkët evropiane të Shqipërisë dhe Greqisë. Sa i përket afateve për firmosjen e marrëveshjes, Bushati tha: "Është folur shpesh për afate, u përcaktua pranvera, fillimi i verës, vjeshta. Besojmë se ndajmë të njëjtin mendim dhe me palën greke, që nuk duhet humbur kohë në këtë proces, sepse problematika tashmë është mbi 70-vjeçare, e stërnjohur dhe të gjitha opsionet janë shqyrtuar në tryezë", -tha Bushati.



## Presidenti pritet me nderime nga Kapitenët Regjentë

### San Marino ambasadë në Tiranë, Meta: Shtytje e re në marrëdhëniet tona

Presidenti Ilir Meta u prit dje, me nderimet shtetërore nga Kapitenët Regjentë, Stefano Palmieri dhe Matteo Ciaçi, gjatë vizitës shtetërore në San Marino. Duke vlerësuar marrëdhëniet midis dy vendeve, Meta theksoi se këto marrëdhënie vetëm në dy vitet e fundit janë intensifikuar ndjeshëm dhe po japin rezultate konkrete. "Qëllimi kryesor i vizitës sime në San Marino është që t'i përkthejmë ndjenjat e konsoliduara të miqësisë reciproke në bashkëpunim të fuqishëm ekonomik e kulturor", -tha Meta. Në këtë aspekt, Presidenti Meta, vlerësoi lart dhe përshëndeti vendimin më të fundit të qeverisë së San Marinos për të hapur një ambasadë rezidente në Tiranë dhe theksoi se hapja e saj do t'i japë një shtytje të re këtyre marrëdhënieve. Me shumë interes u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit në fushën e turizmit, operatorëve turistikë, dhomave të tregtisë, financës, bujqësisë, arsimit, inovacionet, bashkëpunimit ndërmjet televizioneve publike, etj. Në mënyrë të veçantë bashkëbiseduesit vlerësuan angazhimin e të dy vendeve në kuadër të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian dhe ndanë mendimin se, afrimi i tyre me BE-në dhe tregun e përbashkët evropian do të krijojë mundësi të reja bashkëpunimi mes dy vendeve. Presidenti Meta diskutoi me Kapitenët Regjentë të San Marinos edhe mbi sfidat e kërcënimit që dy vendet kanë në këto momente, veçanërisht nga kriza e emigracionit dhe veprimtaria e kriminjtë të organizuar në të dy anët e Adriatikut. U ra dakord që të ketë një bashkëpunim koordinim më të mirë mes strukturave shtetërore të të dy vendeve.



dueshëm. Ne kemi bërë hapa të rëndësishëm në nisjen e negociatave. Ne kemi marrë vetëm datën për hapjen e negociatave, të cilat do të zhvillohen vitin e ardhshëm, por kanë hyrë në një proces të rëndësishëm të fazës analitike, që është faza që fillon

pas fillimit të negociatave. Është një zgjidhje pozitive përmes së cilës nuk duhet të dorëjmojmë një minutë dhe duhet të përdorim këto 12 muajt për procesin analitik", u shpreh Rama. I pyetur për një zgjidhje mes Kosovës dhe Serbisë, Rama ka thënë se për

ja mes Shqipërisë dhe Greqisë, janë një tregues i qartë se kur ka dëshirë, ka edhe zgjidhje. Përjashtim bën fakti që zgjidhja mes Kosovës dhe Serbisë nuk është e lehtë për t'u arritur, por unë besoj se do të vijë", -tha kryeministri Rama.

## SITUATA POLITIKE DEBATI

Padia ndaj kreut të PD-së, Gjykata e Krimeve të Rënda shpall moskompetencë

# Sekuestrimi i 3.4 mln eurove, Basha: Argumentet, padia e gabuar

## Balla: Do të dal fitues ndaj gojëpërdalit

Valentina Madani

Gjykata e Krimeve të Rënda shpalli dje moskompetencë për padinë që kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla bëri për kryetarin e PD-së, Lulzim Basha, pas deklaratave të tij lidhur me çështjen e sekuestrimin të 3.4 milionë eurove në Portin e Durrësit. PD shpërnda një dokument që përmban kërkesën paraprake të pranuar të Bashës dhe argumentet ligjore për çështjen që do të gjykohej në Gjykatën e Tiranës. Në argumentet e kreut të opozitës theksohet se ankimimi në gjykatën e gabuar nga Taulant Balla të mos jetë bërë me disa qëllime: "1-zvarritjen e çështjes, 2-krijimin e rrethanave të rreme për të ndikuar hetimin penal ndaj çështjes ku akuzohet si i përfshirë, 3-mashtrimin e opinionit publik". "Duke vënë në dukje shpejtësinë me të cilën Gjykata e Krimeve të Rënda trajtoi brenda 24 orëve kërkesën e Ballës, që nga procedura e regjistrimit, marrja e saj në dorëzim nga kryetari i gjykatës, hedhja e shortit dhe caktimi i gjyqtarit, marrja në dorëzim e dosjes nga gjyqtari i caktuar, shqyrtimi fillestar i saj, caktimi i seancës gjyqësore dhe përpilimi i aktit për procedurat e thirrjes së palëve në gjykim, Basha shprehet se, "dëshiron të besojë që këtë standard dhe shpejtësi maksimale, gjykata zbaton për çdo çështje që lidhet me krimin e organizuar dhe korrupsionin", thuhet në një njoftim të PD. Z.Balla e paditi Bashën për shpifje, pasi ai e akuzoi si të përfshirë në rastin e kontrabandimit të 3,4 milionë eurove të gjetura në 2 "Toyota Yaris" në portin e Durrësit. Kreu i Partisë Demokratike nuk u paraqiti në seancën e djeshme. Edhe vetë Taulant Balla nuk hyri në sallë, duke i kërkuar avokatit ta përfaqësojë, ndërsa akuzoi kreun e opozitës se i shmanget drejtësisë. Çështja pritet t'i kalojë Gjykatës



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha

së Tiranës. Balla reagoi pas deklaratës së Bashës për shpalljen e moskompetencës nga ana e Krimeve të Rënda për padinë që bëri socialisti ndaj tij. Balla tha se kjo çështje do të gjykohej 10 metra larg Krimeve të Rënda, tek Gjykata e Tiranës. "Është për të ardhur keq që i aku-

zuar për shpifje përmes një deklaratë të partisë së tij akuzon gjykatën për shpejtësinë e ndjekur në gjykim. Është shumë e rëndësishme të lexohet nga të gjithë dokumenti mbrojtës i të akuzuarit Lulzim Basha, në të cilin ai tashmë është tërhequr nga

### DOKUMENTI

Në argumentet e kreut të opozitës theksohet se ankimimi në gjykatën e gabuar nga Taulant Balla të mos jetë bërë me disa qëllime: "1-zvarritjen e çështjes, 2-krijimin e rrethanave të rreme për të ndikuar hetimin penal ndaj çështjes ku akuzohet si i përfshirë, 3-mashtrimin e opinionit publik".

shpifjet dhe nga fyerjet, por synon të mbrohet me procedurën", theksoi z.Balla. Ai lajmëroi se sot do të depozitojë në prokurori prova të tjera. "Mos u fshih Lulzim! Bëje edhe ti një betejë në jetë! Mos prit të të falë gjithmonë Saliu karrige dhe mbrojtje politike", tha Balla.



Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla

### Vdekja e shoferit të Xhafajt, PD: Prokuroria hesht, asnjë transparencë

PD-ja akuzoi dje prokurorinë se prej 10 ditësh hesht në lidhje me vdekjen e shoferit të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në një deklaratë për mediat, PD shprehet se kjo prokurori nuk po bën asgjë transparente me këtë çështje. "Bllokimi i hetimeve për vrasjen e shoferit të Fatmir Xhafajt vërteton përfundimisht se i gjithë sistemi i prokurorisë kontrollon nga Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj. Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Krimeve të Rënda, Prokuroria e Tiranës, Prokuroria e Durrësit janë të gjitha marioneta në duart e Edi Ramës dhe instrumente për të mbrojtur krimin në qeveri. Që pas emërimit të Arta Markut, e cila ndryshoi të gjithë drejtuesit e sistemit të prokurorisë, janë bllokuar dhe zvarritur të gjitha hetimet e rëndësishme kundër krimin, drogës dhe korrupsionit. Pa çlirim të Prokurorisë nga kthetrajt e Edi Ramës, nuk do ketë drejtësi të vërtetë në vend!", thekson PD.



### "NË SHTATOR, REALITET I RI POLITIK"

### "Magjistratura", Paloka: Nuk bashkojmë votat me PS-në

Opozita paralajmëron reagime të forta kundër mazhorancës, të cilat sipas ekspertëve të saj do të ndryshojnë realitetin politik në vend. Nën kryetari i demokratëve, Edi Paloka, nuk specifikon mjete që do përdoren, duke theksuar se i gjithë aksioni është në diskutim, ndërsa sqaron se mungesa e opozitës në seancë dhe komisionet është një qëndrim që ka lidhje vetëm me votimin e ligjit për teatrin. "Reagimi politik jo vetëm për ligjin e teatrit, por për gjithçka që po ndodh në këtë vend do të jetë shumë më i fortë dhe absolutisht deri në shtator ne do të marrim vendime që do ta ndryshojnë realitetin politik në Shqipëri", tha Paloka. PS është në kërkim të konsensusit për ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por Edi Paloka garanton se PD nuk i bashkon votat me mazhorancën as për asnjë ligj. "Çfarë po përpigjen të bëjmë me këtë ligj, t'i japin Arta Markut dhe ca të tjerëve si Arta Marku të drejtën që të zgjedhin prokurorë dhe gjyqtarë që i do Edi Rama", tha z.Paloka.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"  
"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 10.200.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi catering në ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 02 Gusht 2018, ora 10:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**TIRANË** - Një efektive policie dhe një avokat janë arrestuar nga SHÇBA-ja, pasi dyshohet se ushtronin ndikim të paligjshëm te gjyqtarët dhe prokurorët duke marrë para. Burime zyrtare dje bënë me dije se bëhet fjalë për inspektorin Haki Dylji, 60 vjeç, me dytë trupë shërbimi në Sigurinë e godinës së Gjykatës Durrës dhe 40-vjeçarin Devis Qana,



## Pranga policit dhe avokatit, u kërkoi palëve në proces hetimi shpërblim me vlerë 2000 euro

avokat, pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë. Mësohet se ndalimi i tyre u bë në kuadër të një procedimi penal nisur disa muaj më parë për veprën penale: "Ushtrim i ndikimit të paligjshëm, ndaj personave që ushtrojnë funksione publike". Sipas burimeve nga policia, pas

një hetimi me metoda speciale u dokumentua me prova ligjore veprimtaria e kundërligjshme. Të dy këta shtetas, dyshohet se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, u premtori palëve në proces hetimi dhe gjykimi favorizim përmes ndikimit me forma antiligjore. Në këmbim

të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm te gjyqtarët e prokurorët, ata kërkoi shpërblime monetare që varionin deri në 2.000 euro. Ndërkohë, vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të aktivitetit të paligjshëm të efektit të policisë dhe avokatit Qana.

Telefonata, Keisi Hysa la takim me pronarin e një mobilierie në Nikël

# Mister zhdukja e 34-vjeçarit nga qyteti i Laçit, policia nis hetimet

## I riu ishte në kërkim për një vrasje në Sarandë

**KURBIN**

Një 34-vjeçar nga Laçi, i cili ishte shpallur në kërkim nga policia si bashkëpunëtor në një vrasje, është zhdukur që prej disa ditësh. Bëhet fjalë për të riun Keisi Hysa. Dy ditë më parë ish-kryeministri Sali Berisha publikoi mesazhin e xhaxhait të djalit që thoshte se kishin denoncuar zhdukjen e nipit, por ende nuk kishte nisur hetimi. Ndërkohë, mësohet se policia e Kurbinut ka referuar ngjarjen në prokurori, ndërsa sqaroi se 34-vjeçari i zhdukur akuzohej për një vrasje të ndodhur në vitin 2015 në Sarandë. "Sot më datë 09.07.2018, u referuan materialet procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për humbjen e shtetasit K.H., pasi pranë Komisarariatit të Policisë Kurbin ka bërë kallëzim shtetasi S.H., 63 vjeç, banues në Laç, ku pretendon se kanë humbur kontaktet me djalin, shtetasin K.(E).H., 34 vjeç, banues në Laç, që në datën 05.07.2018. Shtetasi i deklaruar i humbur, rezultoi person i shpallur në kërkim, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin të datës 17.07.2015, ka caktuar masën e sigurisë



Policia e Kurbinut

'Arrest me burg' për veprat penale 'Vrasja me paramendim e kryer në bashkëpunim' dhe 'Armëmbajtja pa leje', thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Kur-

binit. Nga ana tjetër, familjarët e të riut kanë ngritur dyshime se ai mund të jetë vrarë. Në lidhje me këtë ngjarje, janë zbuluar detaje të reja. Burime për "GSH"

bëjnë me dije se Keisi Elion Hysa kishte marrë një dyqan me qira në Nikël të Krujës dhe në datën 5 korrik kishte lënë një takim me telefon me një person nga kjo zonë që kishte një mobilieri. 34-vjeçari Hysa rezultoi edhe me dy emra të tjerë, Elvis dhe Eli. Por, pas ditës së takimit ai u zhduk pa lënë gjurmë dhe familja nuk ka më asnjë informacion për të. Pas denoncimit nga xhaxhai për zhdukjen, policia e Kurbinut ka nisur hetimet dhe ka kontaktuar me personin, me të cilin Keisi Hysa kishte lënë takim. Ky i fundit ka pohuar se kishte lënë takim, por 34-vjeçari nuk kishte shkuar, ndaj dhe nuk janë taksuar. Ndërkohë, Drejtoria Vendore e Policisë në Lezhë bën me dije se menjëherë pas referimit të rastit, strukturat policore janë vënë në lëvizje për gjetjen e 34-vjeçarit të zhdukur.



## Lirohet nga burgu, Ballist Morina: Rroftë shpirti i shqiptarit!

**TIRANË** - Lirohet nga burgu Ismail Morina, i cili në tetor të vitit 2014 hodhi dronin me elementet e flamurit shqiptar në stadiumin e Beogradit, atje ku luante kombëtarja shqiptare përballë Partizanit të Beogradit. Ka qenë vetë Ballist Morina që ka bërë të ditur lajmin përmes një postimi në 'Facebook' ku shkruan: "Me konsullin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë të akredituar në Bari të Italisë zotrinë/Dashamirin Adrian Haskaj. Përgëzime të veçanta strukturave të shtetit shqiptar që janë përfshirë në përpjekjet për lirin tim, respekt për Kroacinë dhe Italinë në paanshmërinë e treguar prej tyre dhe mirënjohje gjithë atyre që zbriten rrugëve të kryeqytetit shqiptar në mbrojtjen time.

I LIRË !!

Rroftë shpirti i shqiptarit!!  
Ismail Morina (Ballisti)".

Ndërkaq, Ismail Morina ka postuar edhe një foto me konsullin tonë në Bari, Adrian Haska, ku shfaqet edhe me një pamje krejt ndryshe, i veshur me xhakë dhe pa mjekër. Morina qëndronte prej disa kohësh në paraburgim në Kroaci, ndërsa Beogradi ndërhyri disa herë që ai të ekstradohej në Serbi. Autori i "Autochthonous", u arrestua në Dubrovnik dhe gjykata kroate vendosi fillimisht ekstradimin e tij në Serbi. Por, Gjykata e Lartë e Kroacisë vendosi anulimin e këtij vendimi, ndërsa tashmë Morina është i lirë.

## Sekuestrimi i 3.4 mln eurove, caktohet data për dhënien e masës së sigurisë për 4 të arrestuarit

**TIRANË** - Gjykata për Krimet e Rënda pritet që të japë masën e sigurisë për të akuzuarit lidhur me sasinë e 3.4 milionë eurove që u sekuestruan në portin e Durrësit. Mësohet se seanca gjyqësore për të arrestuarit: Agim Çeka, Edi dhe Klevis Lika dhe Alban Mollaymeri do të mbahet më 12 korrik, në orën 09:00. Vetëm para disa ditësh u gjetën plot 3.4 milionë euro në dy mjete tip "Toyota" në portin e qytetit bregdetar. Dyshohet se këto para burojnë nga trafikimi i lëndëve narkotike dhe po futeshin në të zezë në Shqipëri, ndërsa përveç 4 të

arrestuarve, janë shpallur në kërkim edhe dy të tjerë, të dyshuar si porosistët e parave. Në seancën e fundit të grupit kriminal, prokuroria kërkoi arrest me burg për të gjithë të arrestuarit. Gjykata e Durrësit vendosi të lërë pas hekurave të pandehurit, ndërsa shpalli moskompetencë, duke e kaluar çështjen te Krimet e Rënda, duke qenë se ndaj të arrestuarve është ngritur edhe akuzë si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal.



**Përbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli**, njofton shpalljen për shitje në ankadë të parë për pasuritë e paligjshme si më poshtë:  
- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7549/200 Lekë.  
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-01, fq.-235, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7549/200 Lekë.  
- Pasuria Nr.211/1, Vol.-4, fq.-201, Z.K-1791, Iloji Tokë-Oarë me Sip.-500m<sup>2</sup>, ndodhur në Golem Kavajë, me vlerë 400000 Lekë.  
Ankadë për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 12.07.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Përbarimtare "E.G Bailiff Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se me date 07.08.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II për shitjen e pasurisë të paligjshme Truall me sipërfaqe totale 500 m<sup>2</sup> nga e cila Ndërtëse me sipërfaqe 123 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr pasurie 72/67, Vol.3, Fa.189, ZK.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Jamaku me vlerë fillëtare në ankadë 90,048 (Nentëdhjetë mijë e dyzet e tete) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka bërë thirrje që konsumatorët të tregohen të kujdesshëm lidhur me skemat mashtruese të thirrjeve telefonike, që janë kthyer në shqetësim edhe në vendin tonë. Në një sqarim të gjatë AKEP jep disa detaje për mënyrën sesi funksionojnë këto skema dhe se çfarë duhet të bëjnë konsumatorët në këto raste. Nëse keni thirrje të humbura në aparatit tuaj celular nga numra të cilët nuk i njihni (me prefiks ndërkombëtar) duhet të keni kujdes para se të ktheni thirrjen drejt këtyre numrave. Kjo për shkak se ka shumë mundësi të bini pre e skemave mashtruese të thirrjeve të humbura, duke rezultuar në fatura të

**Skemat mashtruese me thirrjet telefonike**

**AKEP: Ja çfarë duhet të keni parasysh**

larta për përdoruesit me paspagim apo harxhim shumë të shpejtë të krediteve të përdoruesve me parapagim. Çfarë është dhe si funksionon skema e mashtrimit të thirrjeve të humbura? Skema mashtruese e thirrjeve të humbura në industrinë e telekomunikacioneve njihet me emra të ndryshëm si 'missed call scam', 'wangiri scam' apo 'one ring scam'. Këto skema mashtruese përdorin sisteme automatike për të gjeneruar thirrje (mijëra thirrje në minutë) kryesisht drejt numrave celularë, por edhe drejt numrave fiks. Thir-

rja zakonisht zgjat shumë pak duke rënë një herë apo dy herë zilia e telefonit dhe më pas thirrja ndërpritet dhe regjistrohet si thirrje e humbur dhe që më pas ju nga sjellja normale/kureshtja për thirrjet e humbura të kryeni një telefonatë drejt këtij numri (call back). Nëse ju ktheni thirrjen drejt këtyre numrave, mundësitë më të mëdha janë që do të dëgjoni

një mesazh sekretarie telefonike (në gjuhë të huaj) apo nuk do të dëgjoni sinjal të lidhjes së thirrjes, ndërkohë që realisht lidhja është realizuar (connected) dhe aparati fillon të masë kohëzgjatjen e thirrjes. Në këto raste ju jeni duke kryer një telefonatë me çmim shumë të lartë për minutë, duke rezultuar në faturë shumë të lartë për përdorues me kontratë (paspagim) ose harxhim shumë të shpejtë të krediteve për përdorues me parapagim. Kostoja për përdoruesin është shumë e lartë edhe për thirrje shumë të shkurtra drejt këtyre



numrave. Thirrje të tilla shfaqen kryesisht me prefikse ndërkombëtare dhe gjeneruesit e këtyre thirrjeve shpeshohen që të ktheni thirrjen drejt këtyre numrave për të përfunduar thirrjen. Gjeneruesit e thirrjeve të tilla përdorin prefikse ndërkombëtare të ndry-

shme si +249, +252, +212, +370, +371 etj., që u përkasin shteteve kryesisht në Afrikë apo Karaibe, por edhe në vende Evropiane. Shpesh gjeneruesit e tyre tjetërsojnë edhe numrat dhe prefikset duke e bërë të vështjtë gjurmimin e tyre dhe ndalimin e këtij aktiviteti të paligjshëm.

Vetëm 60 për qind e bizneseve kanë dorëzuar deklaratat, pjesa tjetër ende

Ornela Manjani

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka sqaruar sot gjatë një konference për shtyp hapat që do të ndjekë biznesi i vogël që ka hyrë në TVSH për deklarimet. Drejtorja, Vasili Vjero tha se sot përfundon afati i fundit, ku të gjithë tatimpaguesit do të dorëzojnë librat e shitjes dhe të blerjes. Ndërsa për sa i përket deklaratës së thjeshtuar të TVSH-së, afati i fundit është data 14 korrik, por duke qenë se është fundjavë, shtyhet për të hënë, datë 16 korrik. "Deri në këto momente janë 11.700 tatimpagues, të cilët duhet të plotësojnë deklaratën e TVSH. Nga 11.700 janë rreth 60% e tyre të plotësuar nga të gjithë tatimpaguesit me fashën 2-5 mln lekë. Afati i fundit është data 14, pra ka ende kohë për tatimpaguesit dhe mund të përmbushin këtë deklaram. Shohim një rritje të tatimpaguesve, ne iu bëjmë thirrje të shfrytëzojnë ditët e mbetura dhe infrastrukturën që është vendosur në dispozicion. Kemi bërë 3000 vizita në terren në funksion të informimit", - tha Vjero

**SISTEMI I RI**  
Sistemi i ri i Taksës së Vlerës së Shtuar duket se nuk është mirëpritur prej bizneseve të vogla. Frika për t'u përfshirë në të reflektohet në nivelin e ulët të dorëzimit të deklaratave tremujore. Në një kohë që kanë mbetur edhe 4 ditë nga afati për dorëzimin e deklaratave të thjeshtuara, vetëm 60% e subjekteve e kanë plotësuar këtë kërkesë. Drejtorja e Tatimeve, Vasilika Vjero deklaroi se nëse bizneset nuk do të respektojnë ligjin, ndaj tyre do të vendosen edhe penaltite. "Më rezultojnë që janë 988 biznese që kanë kaluar pasiv, biznesi i vogël në 2018, ndërkohë që në 2017 kanë qenë 827, pra kemi një diferencë të vogël që nuk përbën shqetësim", - tha Vjero. Që prej 1 prillit

**Skema e TVSH-së, Vjero: Respektoni afatet për deklarimin, ose penaltitete**

*"Afati i fundit është ditën e hënë, datë 16 korrik"*



Drejtorja, Vasili Vjero

kanë hyrë automatikisht në skemën e TVSH-së mbi 11 mijë subjekte, skemë kjo që është kundërshtuar prej grupeve të interesit me arsyetimin se rriten kostot dhe i çon drejt falimentit. Sipas të

dhënave zyrtare të 'Tatimeve', nga 1 prilli kanë hyrë automatikisht në skemën e TVSH-së 11.700 subjekte, të cilat janë identifikuar nga transmetimet ditore të qarkullimit të realizuar me

pajisje fiskale gjatë vitit të kaluar; si dhe nga të dhënat e vetëdeklaruara në deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të vitit 2017. Ndërsa rreth 60 mijë të tjera janë jashtë skemës së TVSH-së.

Si t'i gjeni 31 kategoritë e punonjësve për efekt të deklarimit për kontributet

Tatimpaguesit, persona juridikë dhe fizikë janë të detyruar të deklarojnë në formë elektronike në administratën tatimore të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), të cilët fillojnë punë për herë të parë apo të punësuar rrishtazi pranë tij, sqarojnë 'Tatimet' në një material informues. Ky deklaram me të dhënat e kërkuara për secilin punonjës bëhet të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës së të punësuarve të rinj apo rrishtazi. Personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar të deklarojnë në formë elektronike në organet tatimore të larguar nga puna, brenda 10 ditëve kalendrike nga data e largimit. Nëse ato nuk deklarojnë largimin brenda këtij afati, detyrimet e tyre për kontributet e sigurimeve llogariten për të gjitha periudhat tatimore deri në datën e deklarimit në organet tatimore të punonjësve të larguar nga puna. Në të dyja rastet deklarimi bëhet vetëm në formë elektronike dhe ai përmblan të dhënat e deklaratës "Deklaratat e të punësuarve për herë të parë, atyre rrishtazi, si dhe e të larguarve nga puna" sipas rubrikave të formularit që gjendet në "e-Filing".

**Treni i ri Tiranë-Durrës, hekurudha përfundon në 2020-ën**

**Shkreli: Çmimi i biletës, 1-1.2 euro**

Çmimi i biletës së udhëtimit në linjën e re hekurudhore Tiranë-Durrës do të jetë 1-1.2 euro. Gjithçka u bë me dije nga zvmministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Artan Shkreli, gjatë diskutimit të projektligjit mbi grantin 35.4 mln euro të Fondit të Investimeve të BE për financimin e rehabilitimit të linjës ekzistuese dhe degëzimit të ri hekurudhor në Rinas. "Ndodh që bileta, parvarësisht se nuk është përcaktuar, është shumë e saktë në përgatitjen e fiz-

ibilitetit të lëvizjes së njerëzve, do luhet midis 1 euro dhe 1.2 pak a shumë. Arsyetja pse nuk është përcaktuar kaq saktë nga ne është fakti që i përgjigjet dhe pyetjes tjetër që operatorët do të jenë të hapur, pra do të jenë operatorë publikë, mund të jenë edhe operatorë privatë, sikurse ekziston edhe mundësia e kombinim-

it të operatorëve", tha Shkreli. Kosto totale e projektit kap vlerën e 90 mln euro, nga të cilat 16 milionë euro do të financohen nga buxheti i shtetit, 36 mln euro hua e Bankës Botërore dhe 35.4 mln euro granti i BE-së. Afati i përfundimit të punimeve është data 31.12.2020, por sipas Shkreli, ai mund të shkelet vetëm për linjën e

re drejt Rinasit. "Deri vitin tjetër, pra bëhet fjalë për 24 muaj, është plotësisht e realizueshme, sepse bëhet fjalë për rehabilitim. Ne ndodjmë që do arrijmë ta realizojmë këtë datë. E vetmja gjë që mund të ketë pikëpyetje do të jetë trakti i ri, i cili do të shkojë deri në Rinas. Parvarësisht se janë bërë studimet, gjatë punës mund të

ketë pikëpyetje që mund ta shtyjnë atë pjesë të hekurudhës brenda targetit mujor", sqaroi Shkreli. Referuar projektit, lokomotiva e re do të jetë me diesel, ndërkohë që për lokomotivën elektrike kërkohen edhe 10-12 mln euro shtesë. Ndërkohë që, sa i takon operimit të linjës, ende nuk është vendosur forma që do të zbatohet, por zvmministri i Infrastrukturës nuk përjashtoi mundësinë e një bashkëpunimi me kompanitë private.



Kategoritë që trajtohen me pension dhe llogaritja për çdo përfitues

# ISSH: Pensionet familjare, formulari për të përfituar

## Dokumentet që duhet të dorëzohen

Ornela Manjani

Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon formularin që duhet të plotësojnë personat që duan të përfitojnë pension familjar. Pensionin familjar mund ta përfitojnë të gjithë jetimët që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë.

### KRITERET

Pension familjar mund të përfitojë e veja që është mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, që nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur moshën 55 vjeç. Gjithashtu, nga kjo kategori pensioni përfiton edhe burri i ve, kur është mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, që është i paaftë për punë dhe që ka mbushur moshën 60 vjeç. Të gjithë ata jetimë që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë dhe që ka mbushur moshën 60 vjeç. Një kategori tjetër që plotëson kushtet janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerka e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë. Edhe nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të trajtohen si jetimë dhe mund të marrin pension familjar. Në momentin që 1/ e veja martohen sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

### PËR LLOGARITJA

Pension familjar konsiderohet at pension që kishte apo i takonte të ndjerit. Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pen-

Faksimile e formularit

### DOKUMENTACIONI:

- Kërkesa për përfitimin e pensionit familjar bashkë me dokumentet e nevojshme paraqitet në ALSSH-në e vendbanimit, sipas gjendjes civile. Dokumentet që shoqërojnë kërkesën për pension familjar janë si më poshtë:
  - Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:
    - Certifikatë e gjendjes familjare.
    - Certifikatë vdekjeje e të ndjerit/ës (ku të jetë shënuar dhe shkaku i vdekjes).
    - Fotokopje e letërsisë së njohimit elektronik për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë.
  - Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës janë:
    - Librezë e punës.
    - Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.
    - Vërtetim për periudhën e sigurimit, e lëshuar nga zyra e arkivit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për punëdhënësit, të punësuarit, të vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të siguruarit në mënyrë vullnetare, si dhe të siguruarit sipas VKM.
    - Vendim gjykate për njohje të vjetërsisë në punë (nëse shikohet e arsyeshme).
    - Vërtetim i vjetërsisë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore, para vitit 1992.
    - Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).
    - Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.
    - Fotokopje e notizuar e diplomës së shkollës së lartë për kërkueset femra (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shkëputje nga puna).
  - Për personat që përfitojnë nga Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 "Për pajafësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" duhen edhe:
    - Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
    - Vërtetim për kohën e vuajtjes së dënimit, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik.
    - Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij, të lëshuar nga Komisioni i Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Drejtësisë.
    - Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë.
- Dokumentet që vërtetojnë të qenit në

- ngarkim të të ndjerit/ndjerës.
  - Krahas dokumenteve të përcaktuara më lart, duhet të dorëzohen edhe dokumentet e mëposhtme:
    - Vërtetim i vazhimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar.
    - Vendim i KMCAP-it për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune.
    - Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i/e ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit.
    - Vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë.
    - Procesverbal, që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KMCAP, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale.
    - Vërtetim i organeve të pushtetit lokal që prindërit, prindërit e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetonin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes.
    - Vërtetim nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga Dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".
    - Vërtetim nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit. Për të marrë këtë përfitim, personi duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë ALSSH-së, ku të deklarojë se nuk është ekonomikisht aktiv (i punësuar ose i vetëpunësuar).
    - Jetimi që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat), në kërkesën për pension deklaroi se nuk është i punësuar ose i vetëpunësuar si dhe paraqet vërtetim nga Zyra e Punës.
    - Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara: Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit-tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribut për periudhat pas datës 01.01.1994). Vërtetim i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës.

### MASA E PËRFITIMIT:

- Pensionin familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit/ës.**
- Personi i/e ve, merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i/e ndjeri/a, kur është i/e vetëm dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij.
  - Kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri.
  - Kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar dhe përfitues janë dy ose më shumë persona, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri.
  - Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes.
  - Jetimi merr pension familjar edhe në qoftë se prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si e drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij.
  - Jetimi që humbet të dy prindërit merr një pension jetimi për secilin prej tyre. Kërkesën për vazhdimin e pensionit familjar, kur mbaron afati i pagesës, përfituesi e paraqet në ALSSH-në e vendbanimit, sipas gjendjes civile, duke i bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar.

### KUSHTET E PËRFITIMIT:

- E veja kur është mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, e paaftë për punë dhe ka mbushur moshën 55 vjeç.
- Burri i ve kur është mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, i paaftë për punë dhe mbushur moshën 60 vjeç.
- Jetimi që ishte në ngarkim të personit që vdiq dhe është nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, nëse studioi ose është i paaftë për punë.
- Prindërit kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerka e njerka kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë.
- Nipërit e mbesat kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të. Në këtë rast ata trajtohen si jetimë.
- I/e veja humbasin të drejtën për pension familjar kur martohen.

sionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ndërkaq, personi i ve merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri kur është i vetëm dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi i cili humbet të dy prindërit ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i pagesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëngjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuiesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkuiesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicion të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

# Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

*Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit*

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKPP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKPP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**KORÇË**

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuës)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuës)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
523	KORÇE	NEXHIP		TAPOLLARI		
	KORÇE					
402	KORÇE	ZYLFTAR		BASHLLARI		
401	KORÇE	KRISTINA		GUSHO		
403	KORÇE	FARI		ZEQOLLARI		
405	KORÇE	DIANA		MYRTOLLARI		
406	POGRADEC	FATMIR		HOKHA		
407	KORÇE	ARBEN		BERBERI		
410	KORÇE					
412	KORÇE	VIOLLAMBI		REMAÇKA		
432	KORÇE	NEXHDET		SHERIRI		
481	KORÇE	ALFRED		THONO		
487	KORÇE	ALFRED		THONO		
488	KORÇE	AGIM		SHTYLLA		
489	KORÇE	GENCI		SHTYLLA		
490	KORÇE					
491	KORÇE	SHKELQIM		VENXHA		
476	KORÇE					
477	KORÇE	ROBERT		PAPI		
480	KORÇE	BUJAR		VEZI		
472	KORÇE	FEMI		BAJRAKTARI		
473	KORÇE	ROBERT		PAPI		
475	KORÇE	ROBERT		PAPI		
71	KORÇE	HALIM		ELEZI		
70	KORÇE	NEKI		KUME		
68	KORÇE	TAMARA		PEMASHKA		
67	KORÇE	KOKO		MELKA		
66	KORÇE	STAVRI		AFEROLLI		
	KORÇE					
64	POGRADEC	BLENDI		COMO		
63	POGRADEC	PIRO		ANGJO		
74	POGRADEC	TODI		BUSHO		
73	POGRADEC	DONIKA		ALICKOLLI		
72	POGRADEC	RENATO		KADILLI		
2	KORÇE	ISLAM		BRENJA	435000	
4	KORÇE	FATMIR		CAMI		
8	KORÇE	LAZI		SULI	20000	
4	KORÇE	LIRUE		BUJARI	123504	
42	KORÇE	BASHKIM		MYRTEZA	22000	
	KORÇE				3000	
269	KORÇE	VALENTINA		MIKAJ	165000	
	KORÇE				22000	
	KORÇE				SHFLQJ E 891 DT 01.04.2009	
30	KORÇE	VASIL		PINE	1305 JMOS 35	
	KORÇE				SHFLQJZIMIN E 1005 DT 15.06.2009 KTHIM PER RISHQYRTIM	
26	KORÇE	JORGOSI		ALEKS	SHFLQJZIMIN E 969 DT 18.05.2009	
194	POGRADEC	NEZIR		FEJZULLAHU	362	
218	POGRADEC	ELVIRA		BASHO	1160	
	POGRADEC				MOS MIRATOJE KERKESEN	
237	POGRADEC	SKENDER		MECE	MOS MIRATOJE KERKESEN	
241	POGRADEC	GJEGJIL		RISTOLLAR	MOS MIRATOJE KERKESEN	
184	POGRADEC	KRISTAQ		MARTINI	872	
201	POGRADEC	VIOLETA		BEKTASHI	MOS MIRATOJE KERKESEN	
212	POGRADEC	PIRRO		SINJAKU	MOS MIRATOJE KERKESEN	
187	POGRADEC	DUSHAN		BUSHO	1050	
177	POGRADEC	KASTRIOTI		GLUSHO	532	
	POGRADEC				18360	
	POGRADEC				160	
	POGRADEC				1358	

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuës)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuës)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
	POGRADEC				1800	
	POGRADEC				13	
243	POGRADEC	HEKURAN		ELMASLLARI		PA VENDIM VETEM KERKESA TIP
260	POGRADEC	ISTREF		PENGU		PA VENDIM VETEM MANDATI DHE F J
254	POGRADEC	ILUR		BEIKO		
81	POGRADEC	LIGOR		COBANI	456	
45	POGRADEC	MEHMET		RAKIPI	330	
40	POGRADEC	GIORGJE		TANE	945	
306	POGRADEC	LIRUE		SHKURTI	430	
158	POGRADEC	RESJUL		BLACERI	1195	
79	POGRADEC	NEXHMI		BLACERI	5161	
	POGRADEC					
9	POGRADEC	AREFI		SHAHO	5000	
213	POGRADEC	VEU		HYSENREGASI	2386	
17	POGRADEC	REIZ		DERVISHI	1100	
	POGRADEC				421	
	POGRADEC				3345	
190	POGRADEC	LUTFI		LUÇKOLLARI	6603	
29	POGRADEC	PIRO		MITLLARI	573	
315	POGRADEC	ILIJAZ		NURÇELLARI	92	
136	POGRADEC	IBRAHIM		ÇEKICI	1121	
	POGRADEC				1033	
91	POGRADEC	MARGARITA		TASELLARI	6603	
188	POGRADEC	DAFET		LUÇKOLLARI	5187	
28	POGRADEC	BESNIK		LAMÇE	490	
78	POGRADEC	BESIM		BIÇAKU	4050	
22	POGRADEC	NEXHIP		MINARROLI	263	
	POGRADEC					
	POGRADEC				1212	
	POGRADEC					
51	POGRADEC	BEKTASH	PASHO	GUXHOLLI	8000	
	POGRADEC				3290	
	POGRADEC					
	POGRADEC				2700	
	POGRADEC					
	POGRADEC					
	POGRADEC				2000	
	POGRADEC					REFUZIM KERKESA
128	POGRADEC	SOTIRAQ		KRISTANI		
148	POGRADEC	NAZMI		BERBERI		
135	POGRADEC	KUJTIM		FERO		
136	POGRADEC	AREFI		SHAHO		
94	POGRADEC	BARDHYL		OLLU		
171	POGRADEC	NALUM		PASKA		
	POGRADEC					
2	POGRADEC	LLAMBI		FRASHERI	MOSMIRATOJE KERKESEN	
62	POGRADEC	IVANE		LLAKMANI	MOSMIRATOJE KERKESEN	
0	POGRADEC	VERXHIL		BOBA		
164	POGRADEC	SANDRI		MILE	2965	
	POGRADEC					
47	POGRADEC					
128	POGRADEC					
33	POGRADEC	XHEVIT		AFESLLARI		
239	POGRADEC	AVDULLA		MUKOLLARI		
156	POGRADEC	BAJRAM		AFESLLARI		
63	POGRADEC	RAMADAN		DEMIRI		
76	POGRADEC	TEZET		BLACERI	4022	
70	POGRADEC	HAMDI		MANCOLLAKU	2714	
114	POGRADEC	RAMADAN		REKHOLLARI		
103	POGRADEC	GICO		GLUCI	MOSNJOHIE	



167	POGRADEC	GURI		MANCELLARI	700
	POGRADEC	KRISTINA		TIKA	MOSNIOHIE MBIVENDOSJE ME NJE VENDIM TIETER
46	POGRADEC	DILAVER		BLACERI	4374
325	POGRADEC	BEKTASH		BEJKO	MOSNIOHIE
286	POGRADEC	KRISAVGJII		KOKOMESHII	160
204	POGRADEC	ASTRIT		SHANO	1247
153	POGRADEC	ALEKSANDER		TRAVANXHI	225.3
131	POGRADEC	NEXHAT		MUKOLLARI	22
17	POGRADEC	KOPI		QIPRO	1250
64	POGRADEC	FONDI		BURNAZI	
	POGRADEC	MITIKA		BURNAZI	226
16	POGRADEC	SKENDER		LEKA	4500
18	POGRADEC	SOTIRAQ		KVICYKU	612
32	POGRADEC	PIRRO		GLUÇI	4374
153	POGRADEC	SKENDER		KILLOMOLLARI	3836
116	POGRADEC	MEDINE		HAMOLLI	299
47	POGRADEC	BEKHET		MUSALLARI	3780
248	POGRADEC	KUTITIM		BLACERI	522
332	POGRADEC	PASHAKO		SULSTAROVA	MOSNIOHIE
39	POGRADEC	ZAIM		FASHO	105
11	POGRADEC	ALEKSANDER		TODOLLI	30
	POGRADEC				702
	POGRADEC				3000
	POGRADEC				885
	POGRADEC				222 /PARABLERJE 108
	POGRADEC				2400
59	POGRADEC	NIKO		GEGRIFITI	315
264	POGRADEC	LUTITIE		NOLLA	770
58	POGRADEC	RUZHDIJE		FEJZOLLARI	SHTUPI
185	POGRADEC	NAZAR		MANCELLARI	104
14	POGRADEC	PELLUMB		MULLAJ	53
196	POGRADEC	YLLI		SIMXHIRI	1266
	POGRADEC				666
973	POGRADEC	SHENTOR		HOXHALLI	40560
974	POGRADEC	REXHEP		CALISHI	3000
977	POGRADEC	NIKO		TANCO	75550
3	POGRADEC	FAIK	SELMAN	CELA	
29	POGRADEC	QEMAL		BERBERI	2824
12	POGRADEC	MUHARREM		GLXHOLLI	3124
	POGRADEC				3743
27	POGRADEC	AFERDITA		NACO	229
23	POGRADEC	LLAZI		LAMO	456
	POGRADEC				MOS MIRATOJE KERKESEN
8	POGRADEC	SHADUJE		LAMCE	MOS MIRATOJE KERKESEN
2	POGRADEC	OLLGA		COMO	312.6
	POGRADEC				1450
154	POGRADEC	AZIS		MANELLARI	4500
	POGRADEC	NEZIBE		MANELLARI	840
	POGRADEC	AZIS		MALLERI	MBYLLIE PROCEDIMI
160	POGRADEC	BEKTASH		GLXHOLLI	
409	POGRADEC	MUHAMET		KADILLI	
139	POGRADEC	FAIK		DAROVA	
137	POGRADEC	LLAZI		MATO	723
	POGRADEC				11642
164	POGRADEC	BEKHET		BERBERI	4702
	POGRADEC				899
15	POGRADEC	KOCO		KRESTE	1800
	POGRADEC				MOSNIOHIE 2637
75	POGRADEC	XHEVDET		MANCELLARI	4000
	POGRADEC				
85	POGRADEC	SHEME		COLLAKU	MOS MIRATOJE 156.25 DHE 260
99	POGRADEC	PIRRO		NACO	454 /MOSNIOHIE 60 221
87	POGRADEC	TODI		LLAKMANI	2000
95	POGRADEC	ENVVER		TOPCIU	NUK NIEH TE DREJTEN E PARABLERIES
	POGRADEC				MOS MIRATOJE KERKESEN
121	POGRADEC	FEJZI		MUKOLLARI	MOS MIRATOJE KERKESEN
118	POGRADEC	IMER		BERBERI	1890
	POGRADEC				3263
	POGRADEC				1776
	POGRADEC				5305 NIOHIE DHE REFUZIM KERKESJE 1075
108	POGRADEC	MARIJETA		ZENELI	MOS MIRATOJE KERKESEN
88	POGRADEC	GAQO		TARO	625

1004	KORCE				DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1005	KORCE	HEKURAN		ZEQIRLLARI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1006	KORCE	KATERINA		KOCI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1007	KORCE	AGIM		MICANI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1008	KORCE	SOTIR		NDINI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1009	KORCE	FATOS		TERRALLI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1010	KORCE	FREDI		RAPO	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1011	KORCE	MEVLADE		BIUMANI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1012	KORCE	ASIME		RIZAJ	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1014	KORCE	PERPARIM		CAUSHI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1015	KORCE	GAQO		MIKO	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

1016	KORCE	SULEJMAN		PARODINA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1017	KORCE	YLLI		SHAHINASI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1018	KORCE	FATIME		AGOLLI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1019	KORCE	VASIL		DEMIRI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1020	KORCE	VANGJEL		ZEMLAJU	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1021	KORCE	NIKO		PUSTEQI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1022	KORCE	DHIMITRAQ		THOMAI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1023	KORCE	BAJRAM		PRENJIASI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1024	KORCE	DEMIRKE		MUKA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1025	KORCE	ADRIAN		HASANKOLLI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1026	KORCE	ILUA		KITA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1027	KORCE	ANESTI		QIRKO	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1045	KORCE	VAJAJ		MANO	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1046	KORCE	ALI		MEMA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1047	KORCE	PELLUMB		MECE	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1048	KORCE	KIÇO		PIKULI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1013	KORCE	RAIF		USHINI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1028	KORCE	LLAZI		BICOLLI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1029	KORCE	RAJMONDA		BOGDANI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1030	KORCE	ROBERT		MOLLA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1031	KORCE	ADRIATIK		MUKA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1032	KORCE	ROLAND		JUPE	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1033	KORCE	NAJUM		DISHNICA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1034	KORCE	XHIDE		SHERIFI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1035	KORCE	SHEZAI		TAHIRI	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1036	KORCE	ARTUR		DHOGA	DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431 DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

(vijan)

Opinion i Ditës

# Paradoksi shqiptar, frikë nga rritja e pensioneve

Sipas zakonisht dhe interesit të tyre, pa hyrë në fuqi "rritja juaj", tregtarët e të gjitha niveleve i rrisin të nesërmen e lajmërimit zyrtar çmimet e shumicës së artikujve ushqimorë, edhe pse marrja e lekëve nga këto "rritje qeveritare" mund të fillojë më 1 prill, më 1 korrik, më 1 shtator..., më 1 janar!



Aman, kryeministri ynë, që "meritojmë e që duam", mos lajmëroni më me javë apo muaj përpara për rritje (qoftë edhe qesharake) rrogash e pensionesh, sepse tregtarët e mëdhenj e të vegjël, e marrin seriozisht, për "rritje mara-ramendëse" apo "një rekord historik". Dashtë ZOTI i ndihmon ata që e kanë për detyrë të gjejnë disa minuta të lira për ta parë me sytë e veta se sa janë rritur çmimet në supermarkete, minimarkete apo tregjet e rrugëve, pas publikimit të "lajmit lumturues" për rritjen e re të pensioneve në rreth 2.8%!

Sipas zakonisht dhe interesit të tyre, pa hyrë në fuqi "rritja juaj", tregtarët e të gjitha niveleve i rrisin të nesërmen e lajmërimit zyrtar çmimet e shumicës së artikujve ushqimorë, edhe pse marrja e lekëve nga këto "rritje qeveritare" mund të fillojë më 1 prill, më 1 korrik, më 1 shtator..., më 1 janar! Ju nuk keni kohë t'i kontrolloni dhe parandaloni nëpërmjet "takimeve gju me gju me popullin", komunikimit online, me "Facebook", me letra të përditshme të gjitha sa ndodhin orë e cast nëpër tregje, rrugë, zyra, spitale, dogana, aeroporte, ministri, gjykata, prokurori, në zyrat e komisarivateve të policisë, në Gardën e Republikës..., sepse vartësit tuaj nëpër këto institucione janë të zënë deri në fytyrë hallet e veta dhe të ortakëve, për t'i shndërruar në kulla dhe komplekse turistike me 5 vje dhjetëra apo qindra miliona eurot futur nëpër skafe, maune, toyota...Apo për t'i detyruar vartësit dhe "skilleverit" e tyre që të kenë në zemër, shpirt, mendje, vota, vetëm "Rilindjen" dhe ju personalisht; që të mos guxojnë të thonë një fjali për ato që shikojnë e bëjnë sheat. Përdryshe, më e pakta është sikterisja nga puna e atyre dhe familjarëve në të afërt dhe më e rënda, "vetëvrasia"...

Për të qenë konkret, për t'ju kursyer kohën për verifikime e kontrole atyre që paguhen dhe përfillojnë jo pak për këtë punë, si dhe për t'ju vënë në dijeni, detyrë që ata e harrojnë shpesh, po ju ndihmoj me disa fakte të këtyre ditëve nga supermarketet, minimarketet apo tregtarët e trotuareve. Nëse ju apo vartësit tuaj futeni në furrat e bukës në Tiranë do të përjetoni "befasi" kur të shikoni se një simitë 50-70 gram me miell gruri apo thekre, ardhur nëpërmjet kompanisë "Devolli" të Kosovës nga magazinat e Cernobilit në Ukrainë apo nga Rusia, rezervuar për kuajt, pelat apo derrat dhe dosat e atyre vendeve si dhe e fryrë në Shqipëri me sodë ose maja, kushton 10-30 lekë. Me këtë çmim dhe gramaturë ia kemi kaluar edhe Gjermanisë. Në këtë vend një simitë apo bukë hamburgeri me të njëjtën peshë, por me grurë ose thekër vendose ose ardhur nga Britania e Madhe, Irlanda, Islanda, Suedia, Norvegjia, Kanada, SHBA-ja, Zelanda e Re, Australia, kushton 10-15 cent. Fatin e simitëve kanë tek ne edhe bukët masive 80-90 lekëshe. Dikur, me një nga këto bukë hante gjithë ditën apo tre vakte një familje me 5-6 anëtarë. Sot nuk u del as për drekë, sepse është fryrë nga brenda e nga jashtë dhe është lehtësuar, si pa u kuptuar apo pa u vënë re nga lart. Po kështu, janë rritur çmimet e biskotave, gjalpit, djathërave, (sidomos atyre kaçkavall), peshqve, mishrave, sallamrave ( shumica

ardhur po nga Serbia). Para rreth 1 muaji një pako 100 gramësh gjalp i pashkrirë ERZENI kushtonte 50-60 lekë. Sot apo më saktë të nesërmen e publikimit të shtetit tuaj për rritjen e pensioneve 2.8% shitet e blihet me 70 lekë. Rreth 5 vjet më parë, domethënë në kohën e Saliut apo më "1938", 1 kg peshk koce, merluc, levrek, barbut... kushton 700-800 lekë. Sot, në kohën tuaj, domethënë të "rekordeve historike" çmimet e këtyre llojve peshqve janë rritur rreth 50-60%, për të mos thënë janë dyfishuar. Gjithashtu, edhe pse ZOTI na ndihmoi gjatë muajve prill-qershor me mot as të ftohë e as të nxehtë, duke mos i vënë në punë kondicionerët, faturat e ujit, u dyfishuan, ndërsa ato të dritave mbetën në nivelin e muajve të periudhës dhjetor-shkurt. E marrim me mend se e keni kohën e lirë shumë të pakët nga hallet e shumta të vendit, të partisë dhe qeverisë; të negociatave të integritimit në BE; të "Internacionales socialiste"; të "ngrohjes së klimës politike" apo të marrëveshjeve me Serbinë dhe Greqinë; të familjes; të sponsorëve dhe ortakëve të "Rilindjes"; të angazhimit personal në online apo me letra me qytetarët, që nuk gjejnë me muaj dhe vite zgjidhje nga institucionet dhe hallkat tuaja vartëse, etj.. Por, sakrifikoni nga një ditë në javë dhe shikoni në qytetet e vegjël si Kavaja, Shijaku, Rrogzhina, Peqini, Cërriku, Pushë-Kruja, Miloti, Laçi, Lezha, Shëngjini, Puka, Fushë - Arrësi, Kukësi, Hasi, Bajram Curri, Bulqiza, Peshkopia, Burreli, Rrësheni, Kurbneshti, Librazhdi, Gramshi, Kuçova, Berati, Policanë, Ballsh, Selenica, Skrapari, Tepelena, Memaliaj, Delvina, Gjirokastra, Erseka, Këlcyra, Përrenjasi...Do të "befasoheni"! "tronditeni" dhe skuqeni pa masë nga turpi kur të shikoni fare "lakurqi" varfërinë dhe mjerimin, në kulmin e autolëvdave qeveritare dhe partiake, në vend e nëpër botë, për "rritje ekonomike", "reko-

nde historike", "përparime të mëdha" në krahasim me vitin 2013, të fundit e "qeverisjes Sali Berisha"...Ah, për pak desh harrova! Mos shikoni në këto qytete me një rën nga veturat tuaja luksoze dhe me eskortë, por me një autobus dhe furgon. Kështu do të keni mundësi të shikoni me sytë tuaj se sa u kushton qytetarëve, sidomos pensionistëve, me 14.000-20.000 lekë në muaj apo atyre me mbështetje sociale rreth 6000-7.000 lekë në muaj, një biletë vajtje-ardhje. Thjeshtë për t'ju ndihmuar: sot një abone e përgjithshme për lëvizje me linjat e autobusëve nëpër Tiranë kushton 1.600 lekë, ndërsa ajo në një linjë 1.200 lekë. E pra, në kohën e atij "Saliut të zi apo të keq" kushtonin gati dy herë më pak.

Për t'ju kursyer kohë, energji, dieta shtetërore mund të mos shikoni në të gjitha këto qytete. Mjafton të shikoni brenda një ditë në 2-3 prej këtyre qyteteve fqinj me njeri-tjetrin në Shqipërinë e Mesme, të Jugut, Veriut. Natyrisht mund të shikoni edhe në të gjitha qytetet e mëdha. Kudo që të shikoni do të gjeni pothuajse një panoramë, pejzazh, tablo. Ka të ngjarë që të tronditeni kur të shikoni se me diferencime të pakta e të lehta në Shqipërinë "e gatshme për të hapur negociatat me BE-në", mbretërojnë papunësia, varfëria, mjerimi, i krahasueshëm me atë migjenian", zhgënjimi, pesimizmi apo pashpresëria; bindja, sidomos tek moshat e reja se "këtu nuk jetohej më" dhe se "duhet ikur sa më parë në SHBA, Kanada, Gjermani, Angli, Francë...". E merrni me mend lehtë se pse të gjithë, ashtu si dhe nga vendet e tjera të Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine, edhe nga Rusia e Kina, dëshirojnë, mendojnë e përpigjen të ikin si emigrant e refugjatë në këto vende kapitaliste, ku qeveris e djathta e jo në vendet komunisto-socialiste, ku qeveris e majta, si në Rusi, Kinë, Korenë e Veriut, Kubë, Venezuelë apo në Serbi, Shqipëri...

Kjo "ekspeditë njohëse" apo ky "turistik" mund t'ju ndihmojë të shikoni me sytë tuaj se sa shumë është shtuar "ushtria" e atyre njerëzve që i shtojnë ditët dhe netët nëpër kafene, pijetore, lojërë fati", që flasin me vete ose janë çmëndur krejt; që rrahin e vrasin fare kot apo për një fjalë goje, gra, fëmijë, prindër, kushërinj, komshinj, kalimtarë të rastit...Gjithashtu, do të keni mundësi të shikoni e kuptoni se sa shumë janë shtuar lypësit nëpër rrugë e lokale; burrat dhe gratë që rrëmihin përditë, nëpër koshat e plehrave, sidomos mëngjesëve herët apo mbremëjeve vonë, duke u ruajtur nga turpërimi se mos i shikojnë njerëz që i njohin...Po kështu, mund të shikoni edhe se sa është shtuar numri i atyre femrave rreth 16-45 vjeçe, që papunësia dhe varfëria i ka shtyrë të shesin nder e trup edhe për 1.000-2.000 lekë të reja. Nëse informoheni prej tyre apo prej ambasadave do të mësoni se ato me më shumë "fat" mbushin trotuare apo lokale nate në Kosovë, Maqedoni, Itali, Greqi, Francë, Zvicër, Angli...

Për të mos rënë padashur ku krejt "rastësisht" viktimë e një mashtrimi apo tradite e praktike nga trashëgimia komuniste, mos pranoi të shikoni për një kafë a teke raki në shtëpitë e listës, që mund të kenë bërë për ju kryebashkiakët apo kryepartiakët e majtë, sepse kështu nuk arrini të krijoni një ide të qartë e të plotë për gjendjen e vërtetë të shumicës së Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Për t'ju parandaluar nervozizmin, stresimin, fyerje e sharje me fjalor, që nuk është mirë t'i dëgjojnë as fëmijët dhe femrat, do t'ju këshilloja që të mos shikoni as në shtëpitë e berishianëve, lulbashianëve, babave, monikakryemadhëve, petrivasilëve, agrondukeve, koçokokëdhimëve... Se, në fund të fundit, nga lodhja juaj e tepruar nga këto sherre e skena ditën e nesërme ju nuk do të keni qetësinë e duhur dhe rendimentin e lartë për t'u angazhuar me mish e me shpirt për të mirën tonë të përgjithshme si qytetarë, si vend e si komb...

Gjithnjë me dëshirën si qytetar, për t'ju kursyer kohë, energji dhe ca mijëra lekë dietash dhe karburant veturash, mund të dëgjoni mëngjesëve edhe emisione radio-telvizive, ku lejohet që qytetarët të shprehin pa frikë e censurë. Mos u tronditni dhe zemëroni kur të dëgjoni se shumica ju mallkojnë juve personalisht, familjarisht, si "Rilindje" e qeveri, me fjalë që u shpërthejnë nga shpirti e zemra... Edhe një këshillë tjetër: Kur të shikoni në këto qytete, nëse ju ngrihet temperatura apo tensioni apo nëse keni ndonjë shqetësim tjetër; kardiak, nervor, në stomak, veshka, kocka, melçi..., merrni me vete ilaçe origjinale franceze, gjermane,

italiane, zvicerane, amerikane... dhe ju nëpër farmaci, sepse ministria jote e shëndetësisë nuk ka pasur mundësi t'i parandalojë e kohë t'i kontrollojë imtësisht konteni-erët apo maunat me "ilaçe të reja" të mocme, të kotshme apo të kobshme. Së fundi, një paralamërim: për të mirën e partisë e të popullit, mos bëni gabim të uleni në ndonjë nga lokalet e qendrave apo shesheve në këto qytete. Larg qoftë, krejt befasisht e papritur, fillon një shi i rrëmbyeshëm dhe i përmbyt brenda një gjysmë ore. Por, meqenëse jemi në ditë korriku e me temperatura të larta, mund t'ju bëjnë keq për tensionin dhe nervat edhe nëqëhtësia e madhe, që reflektojnë plakat dhe fasadat e shesheve apo dozat e radioaktivitetit nga hekurat dhe xhamat e kullave...Ne, pa u merakosur dhe pa llogaritur edhe se po na e nxini dhe shkurtoni jetën dëshirojmë dhe urojmë të jetoni edhe shumë më gjatë se sa shoku Enver dhe mister Soros.

Mendon edhe një pistë tjetër: ju, "me bujarinë dhe njerëzillëkun që ju karakterizon", na rrisni rrogat e pensionet, ndërsa tregtarët, nën hundën dhe para syve të pushtetarëve dhe kontrollorëve tuaj të shumtë, të të gjitha niveleve, e zhvlefëtojnë bamirësinë tuaj apo të qeverisë me rritje të çmimeve, ulje të cilësive e të sasisë; me ushqime e ilaçe me doza të larta hormonesh, helmesh, efektshëm jetëshkurtesue; masivisht me data prodhimi e skadence të falsifikuara...!

Mos vallë këta tregtarë të pashpirt e të pangopur për pasurim vetjak e familjar, edhe duke dëmtuar kuletën, shëndetin dhe jetën e qytetarëve, bëjnë lojë të dyfishtë, "punojnë për SHQUP-in apo babalet" dhe janë "armiq të fshehtë të partisë e të popullit, që duhen "vetëvrarë" apo "vrrarë natën dhe qarë ditën", sipas traditës që na ka lënë Enveri?

Po të jetë kështu e të vazhdojë gjatë ky avaz, që tregtarët, pashpirtësisht e pa logjikë ekonomike, të bëjnë çfarë të duan me çmimet, cilësinë, gramaturat, edhe kur ju u ulni taksat, më mirë mos na i rrisni më rrogat e pensionet, o kryeministri ynë, që "nuk bën të dytë më asnjë nënë"! Me shumë çmime ia kemi kaluar me kohë edhe Gjermanisë! Nuk ka gjë se rrogat e pensionet i kemi rreth 10 fish më të ulta se ato në Gjermani! As se biletat e avionëve i kemi 2-3 fish më të larta se në shumicën e vendeve të rajonit e të botës. As se qysh nga 1912-ta, kemi qenë e jemi ndër më të varfrit e Evropës, edhe pse për pasuritë nën e mbitokësore jemi ndër më të pasurit. Kur të "rilindim"; kur ta mbushim Shqipërinë me kulla 20-40 katesh dhe hotele me 5 vje, me toyota me miliona euro; me refugjatë nga Siria, Libia, Iraku, Afganistani..., kur Greqia të na "dhurojë" naftë e gaz nga copa e detit tonë që i falëm me marrëveshjen e re të detit; kur të anëtarësohemi në BE, gjithnjë "nën udhëheqjen tuaj largpamëse, që njeh vendin fitore, sukses, rritje ekonomike", do ta kapim dhe kalojmë Gjermaninë edhe për këto "vogëlsira" në mirëqenie dhe tregues të tjerë zhvillimi modern e real...



# VIP

Suplement  
*Pages*

E mërkurë 11 Korrik 2018 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Rama krah Merkel në Samitin e Londrës, sërish me atlete të bardha
- Trump: Nuk mund të them nëse Putin është mik apo armik
- Foto që Kumburo nuk do të donte t'ia shihnin kurrë
- Motra e Meghan Markle: Princ Harry, i dobët që u martua me të


Ja propozimi perfekt për  
Einxhel Shkirën.  
Djem kini mendjen!



Enca u bën surprizë  
djemve,  
"Do t'ju plotësoj ëndrrat!"



## Rrëfëhet Alesia Bami:



## Jam pafund e dashuruar

*E akuzuan për fotoshop, flet velina e "Stop":  
Përgjigjen e merrni çdo mbërnyje*

E akuzuan për fotoshop, flet velina e "Stop": Përgjigjen e merrni çdo mbrëmje

# Rrëfihet Alesia Bami: Jam pafund e dashuruar

*"Ja cili është mashkulli im ideal"*

Atë e shohim çdo mbrëmje në një nga emisionet investigative në tv Klan, ku shfaqet ndërsa kërcen nën tingujt e këngëve të fundit nën rolin e velinës. Alesia Bami në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare" ka folur për projektet që e presin këtë shtator dhe planet për pushime. Gjithashtu, bukurshja na ka rrëfyer edhe reagimet ndaj akuzave për fotoshop që i kanë bërë në Instagram ndjekësit e saj. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

**Ku do t'i kaloni pushimet këtë verë?**

S'e kam menduar ende, por sigurisht brenda dhe jashtë vendit tonë.

**Keni ndonjë projekt të fundit pas pjesëmarrjes si velinë të "Stopi"?**

Tashmë është periudhë pushimesh, më pas do të flas për projektet në vazhdim.

**Sa e vështirë është të jesh një modele?**

Po është e vështirë, por dhe shumë e bukur.

Për sa kohë mendoni se do të vazhdoni hobin tuaj?

**Si e sheh veten Alesia në të ardhmen?**

Do e vazhdoj derisa të kem mundësi dhe për disa vite.

**Kush është suportuesja më e madhe e juaja në këtë pasion që keni zgjedhur? Si nisi ky pasion?**

Familja ime. Nisi që në moshën 12 vjeç ku fillova të bëja disa foto profesionale, më pas sfilata, reklama etj...

**Jeni një nga velinat bukuroshe të emisionit "Stop" në Klan tv. Cili është 'incidenti' që mbani mend të keni kaluar gjatë provave që keni bërë?**

Ende asnjë incident dhe uroj ta mbyll këtë sezon kështu.

**A është e dashuruar Alesia?**

Pafund e dashuruar me veten. (qesh)

**Si një vajzë bukuroshe që jeni, me siguri keni marrë propozime të ndryshme nga ndjekësit tuaj. Cili ka qenë më interesanti që se kishit imagjinuar ndonjëherë?**



Nuk është se i imagjinoj shumë propozimet që mund të më bëjnë. Realisht janë të shumta dhe nuk mund të specifikoj ndonjë.

**Ku e sheh veten Alesia pas 5 vitesh?**

Po jetoj të tashmen shumë. Të ardhmen e kam lënë të rrjedhë vetë.

**A keni një person nga i cili frymëzoheni çdo dite e do të donit të ndiqnit hapat e tij/saj?**

Nuk frymëzohem nga askush. Më pëlqen të jem vetvetja dhe t'i realizoj gjërat siç di unë.

**Do të vijoni sërish me kërcimin apo është vetëm një fazë që ndërmoret tek "Stopi"?**


Unë përveçse modele mbi të gjitha jam balerinë, dhe sigurisht që do ta vazhdoj.

**Cili është mashkulli ideal për Alesian? Babai im.**



**Ju kanë akuzuar shpesh për fotoshop, si reagoni ndaj akuzave që ju kanë bërë? A janë të vërteta?**


Nuk më bën përshtypje fare. Është normale dhe janë të mirëpritura ashtu siç ka komente pozitive ka edhe negative. Por përgjigjen e marrin çdo natë duke më parë tek "Stop".






## UJË DHE SAPUN, BORA ZEMANI I LË PA FJALË TË GJITHË

Tashmë të gjithë në këtë periudhë të nxehtë vere mezi presin të shijojnë pak rrezet e diellit. Të njëjtën gjë ka bërë dhe moderatorja bukuroshe, Bora Zemani. Nën rrezet e diellit ajo është shfaqur pa make-up si një engjell i vërtetë. Sa lezet ka, vetëm ujë e sapun!



## RIKTHEHET RIKE ROÇI, JA PROBLEMI I PARË QË HAS NË SHQIPËRI

Edhe pse ajo vendbanimin e ka në Itali, për këtë periudhë pushimesh ka zgjedhur të rikthehet në vendlindje. Ish-banorja e "Big Brother" vendosi të shijojë disa ditë edhe në Shqipëri pas udhëtimeve të saj në jug të Italisë dhe në Turqi. Por sapo ka mbërritur dje ka hasur me trafikun e shumë të në autostradë. "Ja trafiku i Tiranës", shkruan Rikja në një foto të postuar në 'Instastory'. Epo ç'ti bësh, sa mbërriti u përplas më realitetin!




## ENCA U BËN SURPRIZË DJEMVE, "DO TJU PLOTËSOJ ËNDRRATI!"

Të gjithë e kanë një idhull dhe një personazh të preferuar dhe mesa duket Enca di të preferuarin e meshkujve që e ndjekin në 'Instagram'. Në një postim të fundit, këngëtarja shkruan në 'Instastory' se do t'u plotësojë ëndrrat e tyre me anën e një surprize. Ndërkohë në një tjetër foto shfaqet së bashku me një femër tjetër, e cila është një nga yjet e pornografisë botërore, Kendra Lust. Me siguri që vajza do të jetë pjesë e videoklipit të ardhshëm të këngëtares. Presim të shohim çdo të nxjerrë kësaj radhe Enca!



## JA PROPOZIMI PERFECT PËR EINHËL SHKIRËN. DJEM KINI MENDJEN!

Nuk është hera e parë që ajo thotë se nuk i pëlqen të flasë për jetën e saj private, por herë pas here poston diçka me spec lidhur me preferencat që ajo ka lidhur me një mashkull. Kësaj radhe ajo ka postuar në 'Instastory' mënyrën perfekte për të pranuar propozimin për martesë nga një mashkull. "Propozim në hënë", e ku ka më perfekt se kaq, ka thënë Einxhel! Kështu që djem kini vëmendjen, kjo është mundësia juaj për ta bërë bukurshen për vetë!





# Diell, det dhe vetëm pushime! Ja disa nga mënyrat për t'i shijuar në maksimum!

**K**jo është një periudhë kontrastesh në shumë mënyra: ritmi i jetës është i ndryshëm, veshjet po ashtu dhe ditët duken sikur nuk përfundojnë. Kontrasti në dimër dhe në verë "godet" në nivel emotiv, ndaj shijojeni këtë periudhë të vitit në mënyrën më të mirë të mundshme. Edhe nëse e keni të pamundur të shkoni disa ditë me pushime organizoni një fundjavë ndryshe, thjesht për t'iu larguar rutinës dhe të riktheheni në punë më me shumë energji. Mënyrat për ta shijuar këtë stinë të bukur janë të shumta. Po ju sugjerojmë disa



Hani një akulllore apo kos të ftohtë, bëni ushqime të freskëta me prodhimet e stinës dhe kënaquni me fruta të shtrydhura.

#### 5. VISHNI ROBA TË PËRSHTATSHME

Koha më e përshtatshme për të nxjerrë nga dollapi pantallonat e shkurtra, fundet e fustanet e freskëta është padyshim vera, ndaj vishini për të qenë sa më rehat, me kusht që të jenë veshje të përshtatshme. Nga ana tjetër, evitoni xhin-

set dhe bluzat sintetike.

#### 6. JINI TË FRESKËT

Gjatë verës do të ketë shumë ditë të nxehta, por edhe ditë me shi e rrufe. Gjatë ditëve me shi, zgjidhni të qëndroni në shtëpi, të shihni një film në kinema apo të vizitoni një qendër tregtare.

#### 7. ÇLODHUNI GJATË PËSHIMEVE VERORE

Me shumë gjasë kjo është një periudhë kur duhet të keni marrë lejen vjetore apo jeni me pushimet e shkollës.



së bashku dhe argëtohuni jashtë ambienteve të shtëpisë! I kni për të notuar, për të bërë lojëra argëtuese dhe thjesht shijoni verën. Kënaquni në kohën tuaj të lirë për të shkuar së bashku në festa, kinema e teatër. Në verë duhet të përmirësoni marrëdhëniet tuaja dhe ky është një privilegj që në

dimër nuk e keni. Kujdesuni për marrëdhëniet tuaja personale. Nëse nuk mund të takoheni me miqtë, sigurohuni të qëndroni në kontakt me ta, në mënyrë që miqësia juaj të qëndrojë e fortë edhe gjatë pushimeve të verës.

#### 4. SHIJONI USHQIMET E FTOHTA

këshilla për të shijuar ditët e pushimit sa më mirë.

#### 1. UDHËTONI

Bëhuni një grup me miq apo familjarë dhe nisuni me pushime! Fëmijët nuk kanë pse të shqetësohen se do të mungojnë në shkollë, pasi janë pushim. Vera është një periudhë e shkëlqyer për të udhëtuar.

#### 2. MOS E KALONI GJITHË KOHËN NË SHTEPI

Fikni kompjuterin dhe shmangni sa më shumë

mjetet elektronike! Është verë dhe është koha të dilni jashtë shtëpisë e të shijoni motin e ngrohtë. Eksploro- ni ambientin rreth e qark jush, dilni me miqtë ose argëtohuni në pishina. Çdo pasdite, kur dielli është duke perënduar dhe ajri fil- lon e freskohet dilni bëni një shëtitje në qytet. Është një dhuratë që mund t'ia bëni vetes: të shijoni mbrëmjet e bukura të verës.

#### 3. SHIJONI SA MË SHUMË MIQTË

Ftojini miqtë të mblidheni



Nëse keni punë të papërfunduara në shtëpi apo pro- jekte gjatë kësaj vere, përpiquni që t'i përfundoni ato më herët, kështu që nuk do t'ju duhet të nxitoni para se të riktheheni sërish në punë apo në shkollë.

#### 8. MOS BËNI KRAHASIME

Mos kini zili pushimet e të tjerëve, si i kalojnë dhe në çfarë vendi apo shteti. Ajo që duhet të bëni është thjesht të jetoni jetën tuaj. Mos e krahasoni veten me askënd tjetër, pasi jeta juaj mund të jetë e mrekul- lueshme nëse ju e dëshiro- ni një gjë të tillë.



# BULEVARDI

## POLITIK

*Në merrni seriozisht!*

### Rama krah Merkel në Samitin e Londrës, sërish me atlete të bardha

Kryeministri Edi Rama është shfaqur edhe në Samitin e Londrës me atlete të bardha. Ai ka publikuar një video në "Facebook", ku shfaqet krah kancelares Merkel dhe kryeministres May. Por paraqitja me atlete të bardha është komentuar nga mediat serbe "Blic", pasi kritikon Ramën, shkruan se për këtë lloj veshjeje të do të flasë e gjithë bota. Megjithatë, kjo nuk është asgjë e çuditshme dhe e re për kryeministrin shqiptar. Ai u shfaq me atlete edhe në kuadër të nismës së Berlinit në Samitin e Triestes, apo edhe më herët...



### Foto që Kumbaro nuk do të donte t'ia shihnin kurrë

Konfliktet në politikë, përplasjet në biznes, përplasjet e banditëve në klube nate dhe të kriminelëve në rrugë shpesh janë shumë më pak violente sesa mëria e grave për njëra-tjetrën. Këtë e ka dëshmuar aktorja e estradës, Marjana Kondi, që me sa duket nuk i del inati me ministren e Kulturës. Pak kohë më parë gjatë një takimi mes saj dhe artistëve që donin të mbronin teatrin, Mirela Kumbaro, ndoshta pa qëllim i ngatërroi emrin në aktores. Por për një grua dhe mbi të gjitha për një personazh të njohur, ky mund të jetë fundi i botës. Dhe Marjana nuk ia fali. Ajo ka botuar në faqen e saj në "Instagram" që e mban me emrin mariamadalenë një foto ku ministrja ndodhet e ulur në karrigen e saj në sallën e Kuvendit të Shqipërisë gjatë një seance plenare dhe është fotografuar në një moment, teksa pastron hundën me duar, shkruan gazeta "Express".



### Trump: Nuk mund të them nëse Putin është mik apo armik



Presidenti amerikan, Donald Trump tha djesh se nuk mund të vlerësojë nëse homologu i tij rus, Vladimir Putin është mik apo armik dhe se takimi me të do të jetë pjesa më e lehtë e udhëtimit në Evropë, që përfshin pjesëmarrjen në samitin e NATO-s dhe vizitën në Britani. Duke folur para gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë, para se të nisej drejt Evropës në një udhëtim njëjavor, Trump përsëriti kritikën e tij ndaj aleatëve të NATO-s, rreth shpenzimeve për mbrojtje si dhe ka përmendur tensionet politike në Britani lidhur me planet për Brexit. "E kam me NATO-n, Mbretërinë e Bashkuar, që është disa e trazuar dhe kam Putinin. Putin mund të jetë pjesa më e lehtë. Si mendoni ju?", ka thënë Trump. "Do të shohim si do të shkojë", ka thënë ai për samitin që do të zhvillojë me Putinin në Helsinki më 16 korrik. I pyetur nëse Putin është mik apo armik, Trump ka thënë: "Nuk mund ta them tani. Për aq sa di unë, konkurrent".



### Motra e Meghan Markle: Princ Harry, i dobët që u martua me të

Samantha Markle ka sulmuar motrën e saj, Meghan Markle, duke thënë se "Princ Harry duhet të ishte martuar me 'ish'-en e tij, Cressida Bonas". Me anë të një postimi në "Twitter", Samantha e ka etiketuar dukeshën e Sussex si "Dukeshë e Nonsense" dhe se princeshë Diana do ndihej e turpëruar nëse do ishte gjallë. Ajo gjithashtu akuzoi Princin Harry se u përul para gruas së tij të re dhe e quajti atë një njeri të dobët. "Harry është një njeri i dobët që lejoi 'Dukeshën e Nonsense' të nëpërkëmbë njerezit që e rrethojnë, sidomos familjen e saj", shkruan Samantha. Meghan dhe gjysmë-motra e saj, Samantha nuk kanë folur për vite. Kjo e fundit gjithmonë e ka kritikuar aktoren.

## TEATRI

# PROTESTUESIT E TEATRIT E akuzuan për vjedhje, regjisor: Filmi e përplasja me Ramën më 1999

Kastriot Çipi: Çfarë më tha Edi Rama në Kryeministri

Dy prej atyre që nuk e kanë braktisur kauzën e teatrit dhe mbrojtjen e tij, Robert Budina e Kastriot Çipi janë akuzuar dhe në media se janë "të dënuar" për vjedhje. Lajmi i shpërndarë në njësoj kudo, e vinte theksin se "dy drejtuesit e protestës së Partisë Demokratike për teatrin, Kastriot Çipi dhe Robert Budina rezultojnë të dënuar për vjedhje fondesh të filmave me vendim të formës së prerë". Mediat zbuluan "vendimin e marrë nga Gjykata e Rrethit Tiranë", që sipas tyre i shpall dy protagonistët e protestës kundër ndërtimit të teatrit të ri, Kastriot Çipin dhe Robert Budinën, si përvetësues të shumës prej 8.8 milionë lekësh dhe fajtorë për moszbatimin e një kontrate me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë (QKK). Në vijim thuhej se Çipi dhe Budina kanë përfutur një fond nga QKK-ja për realizimin e filmit dokumentar me titull "Film i këputur". Shtohet se filmi me metrazh 60 minuta nuk u realizua edhe pasi ata i tërhoqën 8.8 milionë lekë të dhëna nga QKK. Në vijim bëhet me dije se QKK-ja iu drejtua Gjykatës së Rrethit Tiranë me një kallëzim penal për Çipin dhe Budinën, të cilët thuhet se u shpallën fajtorë me akuzën e vjedhjes



Në foto: Kastriot Çipi

së fondit. Sipas një njoftimi, vendimi mori formë të prerë dhe si rrjedhim ka cilësuar në titullin ekzekutiv. Kur QKK-ja i ka drejtuar një kërkesë Zyrrës së Përmbarimit të Rrethit Tiranë për zbatimin e Urdhrit të Ekzekutimit të datës 22.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në përgjigje të kërkesës, Zyra e Përmbarimit të Rrethit Tiranë i bën të ditur QKK-së se ka vendosur ta pushojë urdhrin e ekzekutimit, sepse të paditurit, pra Çipi dhe Bu-

dina, nuk kanë pasuri për shlyerjen e detyrimit. **SGARIMI**

*Nga Kastriot Çipi\**  
Edhe një herë për Mero Bazën dhe të tjerë si ai "Tema", e Bazes sot më ka akuzuar mua dhe kolegun Budina, si "të dënuar për vjedhje" me vendim gjykatë. Për respekt të opinionit publik, më duhet të bëj këto sqarime:

1. Kolegu Budina ka qenë produktor i dokumentarit në

"Paratë u përdorën për xhirimet që i kam në kasete, Budina pat hequr dorë nga filmi para gjyqit, mos e përlyeni kot"



Në foto: Robert Budina

momentin e aplikimit për fond nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, por jo në kohën kur ka ndodhur procesi gjyqësor civil për "mosrespektimin e detyrimit kontraktor". Në këtë periudhë produktori kam qenë unë. Thënë këtë, emri i kolegut Budina duhej të ishte fare jashtë kësaj historie. Por Meros dhe "rillindjes" i duhej kjo përfshirje që të përbalte edhe më tej protestën për teatrin. Në vijim po pastroj baltën

e hedhur në drejtimin tim. 2. Jo vetëm nuk jam dënuar ndonjëherë për vjedhje, por as jam kallëzuar ndonjëherë penalisht për vjedhje, apo për çfarëdo veprë tjetër penale. Mero shpif qëllimisht. E vërteta është se jo unë si individ, por kompania ime është paditur civilisht për "mosrespektim të detyrimit kontraktor". Dhe mospërbushja e detyrimit kontraktor, me Kushtetutë nuk përbën veprë penale dhe nuk



mund të dënohet me burg. 3. Gjyqi është bërë në mungesë dhe ka marrë formë të prerë pa marrë unë njoftim. Por edhe këto "detaje" Meros nuk i interesojnë. 4. Nuk bëhet fjalë për 8.8 milionë lekë, por për 880 mijë lekë. "Të vjetrat" me "të rejt" ndryshojnë 10-fish, por Mero bën sikur i ngatërron pa dashje. 5. Që vendimi është skandaloz, e tregon edhe fakti se kamatëvonesa për moskthimin e shumës është gati trefishi i shumës së përfutur: 2.2 milionë (të reja Mero!). 6. Letra e qershorit 1999 drejtuar QKK për kthimin shumës dhe zgjidhjen e kontratës është absolutisht e vërtetë. Por pjesa tjetër e së vërtetës është se QKK nguli këmbë se filmi duhej të realizohej patjetër, pavarësisht vonesave. Projekti ynë nuk ishte as i pari, as i fundit që vonohej në realizim. Në këto kushte, kolegu Budina u tërhoq nga projekti dhe punën e vazhduva unë. 7. Pikërisht pse isha i vendosur ta realizoja filmin, nënshkrova një

## KERKESA

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit i ka dërguar një letër Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ku i ka kërkuar të kthejë për rishqyrtim ligjin për teatrin, pasi sipas tyre është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet juridike dhe themelet morale të ndërtimit të shtetit demokratik. Në letër, artistët kërkojnë edhe takim zyrtar në Institucionin e Presidencës me Presidentin e Republikës. Përmes një kapitine me titull "RRETHANAT E ÇËSHTJES" thonë se Kuvendi i Shqipërisë, në mesnatën e së enjtes, më 5 korrik 2018, miratoi ligjin e sipërcituar, i cili sanksionon kalimin tek një ko-

## ARTISTËT, LETËR METËS: KTHE LIGJIN PËR TEATRIN

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, presidentit:  
Bie në kundërshtim me Kushtetutën

mpani private e përcaktuar në ligj me emër, të hapësirës publike në qendër të Tiranës, në zonën ku sot gjendet Teatri Kombëtar. "Nga sa është prezantuar nga përfaqësues të qeverisë në disa dalje e diskutime publike që janë bërë me këtë rast, ideja e projektit është shembja e plotë e godinës së Teatrit Kombëtar dhe ndërtimi në atë hapësirë i një kompleksi kul-lash biznesi, brenda të cilit do të shtrihet edhe një hapësirë me një teatër të ri", thuhet në letër. Që nga momenti i prezantimit të idesë, në vend ka pa-

sur një reaktion publik, për shkak të faktit që një iniciativë ligjore e tillë qëndron kundër parimeve kushtetuese dhe morale, mbi të cilat është ngritur dhe funksionon shteti shqiptar. Për rreth një muaj rresht, artistë, personalitete të artit dhe kulturës, aktivistë të shoqërisë civile, njerëz të letrave, gazetarë, aktorë politikë dhe qytetarë të shqetësuar kanë protestuar në mënyrë demokratike në oborrin e Teatrit Kombëtar kundër kësaj iniciative. Vërejnë se protesta kulmoi ditën e enjte, ku përballë

Kuvendit të Shqipërisë, mijëra qytetarë të revoltuar u kërkuan deputetëve të mos e miratonin projektligjin në fjalë. Ata i bëjnë me dije Metës se mbi pesë mijë qytetarë kanë firmosur një peticion drejtuar presidentit, kryetarit të Kuvendit dhe një sërë personalitetesh vendimmarrës të vendit, duke iu bërë thirrje që të ndalojnë këtë iniciativë ligjore, që në fakt vetëm ligjshmeri nuk ka. Procesi i firmosjes vazhdon dhe do Ju dërgohet edhe Juve një kopje e peticionit në përfundim të tij.

Në pjesën "Analiza juridike dhe shkeljet kushtetuese", Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit thotë se ligji bie ndesh me Nenin 3 të Kushtetutës, i cili përcakton trashëgiminë kombëtare si baza mbi të cilën ngrihet shteti shqiptar dhe ngarkon këtë të fundit si përgjegjës për ruajtjen dhe respektimin e saj. "Godina e Teatrit Kombëtar, si një objekt gati njëshekullor, që i ka mbijetuar një luftë botërore dhe tri epokave të ndryshme të shtetit shqiptar, e bën atë pa dyshim një përfaqësues të drejtëpërdrejtë të trashëgimisë kombëtare dhe një specifikisht të historisë së artit shqiptar. Ligji i sapomiruar, i cili vendos për shkatërrimin e saj, pa tentuar të paktën as teorikisht mundësinë e meremetimit të tij në rast se kushtet inxhinierike e përcaktojnë godinën si të rrezikuar, e vendos

qeverinë dhe rrjedhimisht këtë ligj, në kushtet e kundërshtimit të përgjegjësisë kushtetuese për mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare", thuhet në letër. Sipas tyre, së treti, me këtë ligj shkellet parimi i sanksionuar në nenin 4, pika 1 të Kushtetutës: "E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit". Që do të thotë se asnjë institucion shtetëror nuk mund të veprojë jashtë kompetencave të tij ligjore dhe kushtetuese, sepse ato përbëjnë bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së atij institucioni. Sipas tyre, nëse do të lejohej ky precedent në fushën e ligjërjes, atëherë çdo mazhorancë do të miratonte ligje personale pa kufi dhe nuk do të mbante asnjë përgjegjësi në lidhje me abuzimet, pasi do të justifikohet pas kartonëve të parlamentit.





kontratë bashkëprodhimi me TVSH dhe fillova xhirimit. Pasi mbarova të gjitha intervistat dhe xhirimet në Tiranë dhe prisja ardhjen e personazhit të film-it, regjisorit Viktor Stratoberdha, nga Greqia, ku ishte

emigrant, për intervistën kryesore, mësova se ai kishte emigruar sërish, këtë herë në Kanada, ku kishte fituar statusin e azilantit politik. Në këto kushte, ai nuk mund të vinte në Shqipëri, pasi kjo do t'i shkakonte humbjen e statusit të azilantit politik, atij vetë dhe familjes.

8. Në tetor 1999 unë dhashë dorëheqjen nga funksioni i nëndrejtorit të Teatrit Kombëtar dhe dola publikisht kundër politikave anti-teatër të ministrit të Kulturës, Rama dhe projektligjit "Për Teatrin". Nga ky moment, mes meje dhe QKK nuk pati më mirëkuptim dhe vullnet për zgjidhjen e problemeve që lidheshin me realizimin e filmit. Në vend të një rishikimi buxheti, që do të përfshinte edhe mbulimin e shpenzimeve për një udhëtim të grupit të xhirimit në Kanada, ku ndodhej personazhi i filmit, QKK filloi të më padiste në gjykatë për "mosrespektim detyrimisht kontraktor". Këtë ma bëri të ditur vetë Edi Rama, në takimin në Kryem-

ministri, më 8 shkurt 2000, ku isha pjesë e përfaqësimit së artistëve që kundërshtonin projektligjin "Për Teatrin". Kërkoje Mero, se do ta gjeësh në transkriptin e takimit.

9. Më 31 maj 2000, personazhi i filmit tim ndërroi jetë, duke e vështirësuar edhe më tej realizimin e filmit.

10. Pavarësisht gjyqit në mungesë, hyrjes në fuqi të vendimit pa marrë njoftim unë si subjekt i interesuar, kamatëvonesës edhe më absurde me vlerë trefishin e shumës së përfituar, në vitin 2014 bëra një përpjekje për të shkuar individualisht në Kanada (sepse e kisha të pamundur të financoja udhëtimin e një grupi të plotë xhirimi) dhe m'u refuzua viza.

Ajo që mbetet në të gjithë këtë histori është pengu im për mosrealizimin e filmit, kasetat-video në sirtarin tim, që QKK nuk i pranon dhe përdorimi politik i këtij vendimi absurd gjyqate, sa herë unë jam i përfshirë në një konflikt publik me Edi Ramën.

\*Regjisor

## Bashkëshortja e Robert Budinës: Gënjejnë, propagandë fashiste

Ka reguar dje pas klajmit, edhe producentja Sabina Kodra, bashkëshortja e Budinës. Duke përgënjeshtuar lajmin e përhapur, ajo e konsideroi fushatën si propagandë fashiste.

**Ja reagimi i saj i plotë:**  
Nuk jam fare e çuditur nga gënjeshtria e hedhur sot në publik. Jo pa qëllim makineria e propagandës fashiste së fundmi akuzon Robert Budinën për shpërdorim dhe vjedhje të fondëve. Një manipulim në dritë të diellit i një procesi institucional ku zotëria në fjalë nuk ka asnjë



lidhje. Çdo përpjekje për ta sqaruar publikisht këtë shpifje është një kohe e humbur. Por është e sigurt se kjo është një përpjekje për të na demoralizuar; për të hequr dorë nga një kauze

sublime. Po kjo është një kauzë sublime sepse është kauza më e drejtë për të folur e me gojen plot kundër instalimit të diktaturës. Pjesën e shpifjes e sqarojmë në gjykatë. Uroj të kenë avokat të mirë për të mbrojtur llumin që kanë gatuar me shumë përkushtim. Të tjera shpifje e akuzat pres ditët në vijim... sepse diktaturat kanë makineri shumë të mëdha për të shtypur njerëzit e ndershëm. Se di pse por më duket se edhe diktatura komuniste këto mekanizma përdorte, apo gabohem!?



Nëse kuadri kushtetues dhe ligjor aktual nuk arrin ta ndalë këtë precedent, atëherë kush mund ta ndalojë që nesër Galeria e Arteve, Kryeministria, Muzeu Kombëtar e me radhë t'i nënshtrohen të njëjtës formulë?

"Në pikëpamjen tonë shteti nuk mund të ketë qasje klingeru në treg. Shteti

udhëhiqet dhe nga solemniteti. E para është rrëzimi i parimit të 'check&balance'. Momenti i zgjedhur për të kaluar një ligj kaq të debatuar, kur mungesa e kuorumit në Gjykatën Kushtetuese e bën këtë të fundit një hallkë të munguar, që ndërpret rrjedhën e apelimit të një iniciative ligjore, rrëzon parimin e sipërpërmendur.

Nëse qytetarëve u hiqet e drejta e apelimit dhe pretendimi për të rrëzuar iniciativa ligjore të konsideruara si të padrejta nga një pjesë e tyre, atëherë sapo është minuar kolona bazë e demokracisë dhe e vendos vendin de facto në një regjim totalitar, ku qeveria ka pushtet total dhe çfarë do që të bëjë dhe askush nuk bën dot asgjë për ta korrektuar", thotë Aleanca në letrën dërguar Metës.

Nisur nga arsyet e mësipërme, ata kërkojnë që Meta të kthejë për rishqyrtim dhe korrigjim në parlament Ligjin "Për caktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt 'Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar' si në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, parimet juridike dhe themelet morale të ndërtimit të shtetit demokratik.

### KONFERENCA

## AKADEMIA SHPALL NOMINIMET PËR VEPRAT MBI SKËNDERBEUN



Agjencia e Prokurimit Publik pengon punën e Akademisë së Shkencave

kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë, si dhe autorë të interesuar për të paraqitur në konkurrim vepra të realizuara e që përputhen me kërkesat e konkursit. Ishte një befasi pozitive, që u krijua një masë e konsiderueshme botimesh, e cila e angazhoi jo pak jurinë që të dalë në vlerësim të bazuara për çdonjërin nga veprat e përzgjedhura e të paraqitura për konkurrim. Në datën 30 qershor 2018, juria realizoi mbledhjen e saj të dytë, në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave.

Pasi përzgjidhi 30 botime dedikuar kësaj figure, të botuara nga viti 2000-2018, akademia përzgjidhi 3 botimet më cilësore ndër au-

Schmitt me veprën "Shqipëria Venedikase", K&B, 2007, sjellë në shqip nga Ardian Klosi. Për realizimin më të mirë në fushën e bukinistikës e të botimeve anastatike të dorëshkrimeve të rralla, juria pasi shqyrtoi botimet e paraqitura vlerësoi dhe konkludoi që prurjet nuk përmbushin kriteret e përcaktuara dhe për këtë arsye nuk do të ketë asnjë nominim. Juria u pajtua unanimisht me propozimin në këtë mbledhje për t'i propozuar Kryesisë së ASH organizimin e një seance të posaçme (in honorem) për të nderuar personalitetet të shquara shqiptare dhe të huaja, veçanërisht ato që i kanë dhënë kontribute të



Quo Vadis shkenca? Mungojnë botimet anastatike, prurjet nuk përmbushin kriteret

torët shqiptarë. "Për veprën më të mirë shkencore të realizuar nga autorë shqiptarë, u përzgjidh Aurel Plasari me veprën 'Skënderbeu-një histori politike'. Autori tjetër është Kasem Biçoku për veprën e tij "Toponimi mesjetarë në studimin e historisë së Skënderbeut" dhe autori i tretë Petrika Thëngjilli për veprën 'Skënderbeu-arritje, mangësi e pikëpamje të ndryshme", u shpreh Pëllumb Xhufi. Për veprën më të mirë shkencore dhe/ose dokumentare shkruar nga autorë të huaj, shqip, ose në gjuhë tjetër: - Jose Manuel Floristan, "Marrëdhëniet mes Mbretërisë së Napolit me Shqipërinë", seri studimesh botuar në revistën shkencore "Erytheia", me mbi 25 artikuj shkencore në 1990-2017; - Lucia Nadin me veprën "Shqipëria e rigjetur", "Onufri", 2012; - Oliver

veçanta nëpërmjet studimeve të tyre mbi figurën e Skënderbeut dhe epokën e tij, duke propozuar personalitetet më poshtë, pjesë e të cilëve nuk jetojnë më: Franz Babinger; Halil Inalcik, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Alain Ducellier dhe Peter Bartl. Për këto personalitete do të përgatiten prezantimet në seancën e veçantë in honorem. Kryesisë së Akademisë së Shkencave u janë propozuar edhe emrat e studiuesve shqiptarë e të huaj, që do flasin për veprën e meritat në albanogji të personalitetëve të mësipërme (Oliver Schmitt, Ferit Duka, Luan Mëlltezi, Floresha Dado, Pëllumb Xhufi, Bardhyl Demiraj). Juria i propozoi Kryesisë së Akademisë çeljen me këtë rast të "Librit të Artë të Meritës në Albanogji", ku të jenë emrat e personalitetëve.

Opinion i Ditës

# Shteti i së drejtës apo sundim me ligje?

Nga Dr. Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... zhvilluar me dhjetëra veprimtari kudo në botë mbi këtë temë të mprehtë, ku autori ka qenë i pranishëm edhe si diplomat. Ndaj, pa e lodhur lexuesin me analiza akademike, le ta themi me fjalë të thjeshta se "sundimi i ligjit ose shteti i ligjor" vjen nga anglishtja "the rule of law" dhe i referohet traditës së shquar anglo-saksone. Ai përkufizohet si një sistem ku të gjithë i nënshtrohen dhe përgjigjen përpara ligjit, që zbatohet drejt dhe me gjykata të pavarura. Në pamje të parë duket se këtu mungon "e drejta", por në si Britani dhe në SHBA ku zbatohet ky aspekt është zgjidhur bindshëm në forma të tjera. Në fakt, kjo ndodh sepse ndryshe nga gjuhët e tjera të mëdha, anglishtja ka vetëm një fjalë për "ligj" dhe "e drejta", ndaj shqipërimi më i saktë në këtë rast do të ishte "sundimi apo më mirë shteti i të drejtës".

"Shteti i së drejtës" është më i përshatshëm dhe për faktin se me "sundimi i ligjit", "shtet i ligjor" kanë abuzuar shumë vende diktatoriale me pretendimin se kanë ligje moderne, të miratuara sipas kritereve përkatëse, madje edhe sipas modeleve evropiane dhe amerikane, edhe pse këto të fundit të kopjuara mekanikisht në një truall krejt të kundërt me demokracinë pluraliste. Këto lloj klikash ose kastash kanë sunduar me dhunë sipas sloganit të njohur "ka ligj, por ka dhe Malliq". Kështu pretendonte edhe regjimi ynë monist, ku fjala ligj dhe barazia përpara tij ishte refren i preferuar propagandistik. Përditë dalin fakte të reja që tregojnë se atje *ligji* jo vetëm nuk garantonte të drejtën dmth., zbatimin e tij për të gjithë njëllë, por e dhunonte atë me të gjitha format. Po, formalisht atje ligjet miratoheshin nga Kuvendi Popullor, por me vullnetin dhe urdhrin e Njëshit të Partisë-Shtet; aq sa Kushtetuta socialiste e vitit 1976 e sanksionoi qysh në hyrje "rolin udhëheqës të partisë". Shkurt, në diktaturë nuk bëhet fjalë për "sundim ligji" sipas konceptit perëndimor dhe atij anglo-sakson, por për një shtet politik dhe policor, ose të diktaturës së proletariatit, që vetëm se sundonte përmes ligjes. Kurse shteti i të drejtës është krejtësisht i kundërt në përmbajtjen e vet. Ai dallohet thelbësisht, sepse ligjet dhe e drejta në përgjithësi aty hartohen dhe zbatohen në kuadrin e pluralizmit politik, ku janë aktive dhe opozita, me zgjedhje të lira dhe të ndershme, me shtyp të pavarur, ku ka shoqëri aktive civile, ndarje të tri pushteteve, liri fjale dhe grumbullimi, ku nuk ka diskriminim; dallimi tjetër i madh dhe "gurë prove" për shtetin e së drejtës janë mekanizmat/garancitë reale për zbatimin e tij; këtu veçohen Konventa dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut,



Këshilli i Evropës që ka një Drejtori të Përgjithshme të Shtetit të së Drejtës, OSBE/ODIHR, konventa dhe traktatet të tjera ndërkombëtare.

Këtë e saktëson edhe përkufizimi i tij si një shtet kushtetues, ku pushteti shtetëror kufizohet me ligj, me qëllim që të mbrohen shtetasit nga ushtrimi arbitrar i pushtetit, të gëzojnë liritë e tyre civile dhe t'i mbrojnë ato në gjykata të pavarura brenda dhe jashtë vendit. Ky koncept që nuk është vetëm juridik, por edhe politik, filozofik e fetar është më i plotë se "sundimi i ligjit", sepse përfshin qartë dhe aspektin e "të drejtës".

Shteti i së drejtës përbëhet nga katër parime bazë të njohura ndërkombëtarisht - ligje të drejta, llogaridhënia, qeverisje e hapur dhe zgjidhje e paanshme e konflikteve. Këto parime zbrëthenen në nëntë tregues konkretë - kufizimi i kompetencave qeveritare, që ajo të mos jetë e ploffiqishme, por të respektojë ndarjen e pushteteve,

transparenca qeveritare, lufta kundër korrupsionit, vendosja e rendit dhe e rregullit, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, zbatimi i detyrueshëm i ligjeve dhe drejta civile/penale.

Në këtë hierarki, drejtësia përbën thelbin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimit demokratik. Sepse pa drejtësi të pavarur, liria dhe demokracia mbeten slogane boshe. *Ndaj dhe një nga tri shtyllat themelore të BE-së, krahas Krizterizmit dhe Demokracisë greke, është drejtësia romake.* Këtu qëndron dhe rëndësia e zbatimit të drejtë të procesit të vetingut në vendin tonë, vendimtar për fatet e demokracisë dhe anëtarësimin në BE.

Mirëpo vitet e fundit vërehet me shqetësim se shteti klasik i së drejtës po lëviz në dy kahe të ndryshme, që më vonë mund t'i kundërvihen njëri-tjetrit. Në disa vende të mëdha që e kanë ndërtuar me kohë shtetin e së drejtës, po

e "veshin dhe ngjeshin" me tipare dhe kompetenca autoritariste; dukuri dhe prirje të ngjashme antiliberales po vërehen edhe në disa vende anëtare të BE-së, të ish-Evropës Qendrore dhe Lindore, që deri vonë kanë qenë forca politike qeverisëse në pararojë të reformave demokratike dhe liderët e tyre ish-të burgosur politikë të komunizmit; madje duke goditur pushtetin e pavarur gjyqësor, shoqërinë civile, shtypin e lirë etj., atje po hidhen hije dyshimi mbi parimet dhe vlerat universale të shtetit të së drejtës me lloj-lloj hilesash autoritariste.

Shenja, shfaqje dhe mesazhe shqetësuese po vërehen edhe në vende perëndimore me tradita në këtë fushë si në Francë, Itali, Austri etj. Në Gjermani, krahas partisë ekstremiste "Alternativa për Gjermaninë" (AfD) që po bërtet për "rënien e shtetit të së drejtës" me këtë gjë po abuzojnë edhe politikanë të njohur, edhe pse ndoshta për sh-

kaqe thjesht zgjedhore të përkohshme. Ata po flasin gjithnjë e më shpesh për "dështimin e shtetit të së drejtës" "sabotatorë" armiq, tradhtarë, refugjatë" etj.

Për pasojë, ithtarët/pasuesit e shtetit autoritar të së drejtës sot po kërkojnë që shteti të kujdeset kryesisht "që në territorin e vendeve të tyre të punohet për lumturi të plotë, qetësi, rend, siguri dhe rregull, kundër armikut të brendshëm e të jashtëm", madje janë vetë ata që i përcaktojnë se kush janë armiqtë-emigrantët, terroristët, sabotatorët, opozita, shtypi etj. Nga ana tjetër, përshkallëzimi dhe ardhja në pushtet e forcave nacionaliste, ekstremiste dhe populiste rrezikojnë ta kthejnë shtetin e së drejtës në dhunë të pajustificuar të pushtetit, me qëllim që të korrin "fitoren mbi armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm". Ndërsa mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore, shoqërisë civile, shtypit të lirë, drejtësisë së pavarur etj., të kalojnë në plan të dytë, në sfond.

Kësisoj, siç paralajmëron gazetarja dhe publicistja e njohur gjermane Verena Weidenbach, po lind dhe zhvillohet në teori dhe në praktikë shteti i së drejtës konservatore dhe autoritar; që po të mos hasë në rezistencë dhe kundërshtimin masiv, më vonë mund të çojë në zëvendësimin e tij me shtetin politik dhe policor, ose sundim përmes ligjes. Aq më tepër që siç po tregon përvoja e viteve të fundit, edhe aderimi në BE, NATO dhe gjetkë nuk jep kurrfarë garancie dhe imuniteti, ca më pak të kthehet në "kurë magjike" ndaj sëmundjeve të shteteve politike dhe sociale.

Për shkak edhe të trashëgimisë politike "sui generis", këto dukuri negative kanë qenë dhe mbeten rreziqe reale edhe për vendin tonë. Dihet tiparet autoritariste të shtetit tonë në vitet '90, dështimi i Kushtetutës së vitit 1994, që mbështeste ato prirje bashkë me synime dhe dukuri të tjera negative në të kaluarën e afërt. Por edhe tani, me gjithë përparimet jo të pakta, kemi një prani alarmuese të korrupsionit, trafiqeve dhe krimin të organizuar, dështimin e turpshëm të drejtësisë dhe fetishizimin e votës popullore, pavarësisht problematikës së njohur në funksion të veprimeve dhe sjelljeve politike që bien erë autoritarizëm etj., veç dëmtimit të shtetit të së drejtës, këto dhe dukuri të tjera po prodhojnë kryesisht votues pasivë, që shfaqen njëherë në katër vjet, kurse shteti liberal i së drejtës dallohet nga qytetarë aktivë, që e thonë fort fjalën e tyre çdo ditë, në të gjitha format dhe organizmat përkatëse dhe që dëgjojnë e respektojnë nga qeveria dhe shteti. Së fundi, kërkohet efektivitet shumë më i lartë në zbatimin e Shtetit të së Drejtës, që ai të mos mbetet në letër dhe dokumente, as për "show" apo për hatër të negociatave me BE-në, por si një realitet i prekshëm për të gjithë.



Opinioni **i** Ditës

# Thanza i hetuar për korrupsion, pikëpyetje mbi integritetin e tij

Nga Zëri i Amerikës

(vijon nga faqja 1)

... dhe prokurorëve, zbuluan sot se gjyqtari i Gjykatës së Lartë Admir Thanza ka qenë dënuar në vitin 1999 për vjedhje në Itali ku dhe është dënuar. Gjatë seancës dëgjimore, gjykatësi tha se kishte marrë përsipër krimin për të ndihmuar një të afërm të tij, por ai e ka mbajtur të fshehur këtë fakt. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka gjetur probleme në të tri shtyllat e rivlerësimit, ndërkohë që gjyqtari Thanza rezultoi të jetë hetuar dhe për korrupsion, në një çështje të mbyllur më pas nga prokuroria.

Ndërsa nuk ka mbushur ende 50 vjeç, gjyqtari Admir Thanza ka pasur një karrierë për t'u pasur zili, me një ngjitje të shpejtë në majat e sistemit, nga anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në anëtar të Gjykatës Kushtetuese në moshën 40 vjeçare dhe aktualisht në Gjykatën e Lartë. Por sot, në seancën dëgjimore të procesit të rivlerësimit, ai pa se gjithçka rrethikon t'i shembet para syve.

Atij i janë komunikuar probleme me pasuritë e deklaruar: fshehje të të ardhurave apo deklarime të rreme. Probleme janë konstatuar dhe në vlerësimin profesional, për mënyrën e administrimit të dosjeve. Ndërsa goditja më e madhe ka ardhur lidhur me integritetin e figurës së tij.

Ekspertët ndërkombëtarë që asistojnë procesin kanë zbuluar një fakt që ai e ka mbajtur fshehur prej shumë vitesh e që nuk e ka deklaruar as gjatë procesit të rivlerësimit.

Në qershor të vitit 1999, ndërsa ishte në funksionin e gjyqtarit, ai është dënuar nga Gjykata e Pizës në Itali me 40 ditë burgim dhe 100 mijë lireta gjobë për vjedhje në bashkëpunim me të tjerë, madje ka qenë vetë i pranishëm në sallën e gjyqit kur është dhënë vendimi.

Gjyqtari e ka pranuar këtë ngjarje, duke shpjeguar se ai nuk e kishte kryer vjedhjen porse kishte marrë përsipër aktin e bërë nga kunata e tij për të shpëtuar nipin që ndodhej i shtruar në spital nga një sëmundje e rëndë, dhe nëse do të dënohej e ëma atëherë ajo do të kthehej në Shqipëri dhe nipi s'do kish pasur mundësi kurimi.

Po ashtu ndaj tij, u bë i ditur dhe një tjetër fakt i vetëm para dy viteve të cilin ai s'riësh nuk e kishte deklaruar në formularët e vetingut.

Për gjyqtarin Thanza, ka patur dhe një procedim penal për korrupsion. Ndërsa policia vëzhgoonte të afërmin e një të dyshuar për një vepër penale, ajo ka filmuar takimin me gjyqtarin Thanza. Dyshimet kanë qenë për një pagesë e bërë në favor të tij që ai të ndërhynte për të lehtësuar pozitën e të akuzuarit në gjykatën e Shko-



drës. Por çështja është mbyllur në korrik të vitit 2016 nga prokurori Kosta Beluri.

Koincidencë ose jo, prokurori Beluri kishte radhën sot pas gjykatësit Thanza që të dilte para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ndërsa pasuria e tij ka rezultuar pa probleme, pushimi i çështjes ndaj Thanzës ka qenë pika e errët në procesin ndaj tij. Rreth këtij momenti janë vërtitur edhe pyetjet e trupës gjyquese, ndërsa prokurori ka deklaruar se çështja

i ka kaluar atij dy muaj nga momenti i filmimit, gjë që e pamundësonte vërtetimin e korrupsionit të dyshuar. Sipas tij policia do të duhet të kishte ndërhyrë për të bërë ndalimin në flagrancë. Ai deklaroi, gjithashtu, se pamjet që i ishin vënë në dispozicion nuk kishin qenë të qarta, ndryshe nga ato që zotëron vetë KPK për ngjarjen, duke këmbëngulur më pas, se ishte i bindur se kishte vepruar drejt.

Por nëse shpjegimet e tij kanë qenë bindëse ose jo për Komisionin, kjo mbetet për t'u mësuar pas dy ditësh, ndërkohë që për Thanzën, vendimi do të jepet pas një jave.

Në qershor të vitit 1999, ndërsa ishte në funksionin e gjyqtarit, ai është dënuar nga Gjykata e Pizës në Itali me 40 ditë burgim dhe 100 mijë lireta gjobë për vjedhje në bashkëpunim me të tjerë, madje ka qenë vetë i pranishëm në sallën e gjyqit kur

## HOROSKOPI

### DASHI

Gjatë ditës mendoni për dashurisë dhe gjatë natës mendja juaj krijuese përpunon ide të shkëlqyera, të cilat kanë zbatim të vazhdueshëm. Dhe më e bukura është se ndiheni në formë, edhe pse keni sforcom të trupit dhe mendjes gjatë veprimtarisë suaj.

### DEMI

Mosmarrëveshjet në familje në mëngjes do të zgjidhen nga pasdija, falë dashurisë, por edhe Hënës që zhvendoset. Armëpushim do të nënshkruhet para një akulloreje të shijshme, me ngjyra të ndezura, ashtu si personaliteti i juaj i hareshëm.

### BINJAKET

Kini kujdes që të mos nënshkruani kontrata që nuk ju përshtaten. Në lidhje me një çështje delikate kërkoni ndihmë një kolegu me më shumë përvojë, i cili do t'ju mbështesë. Për sa i përket jetës së çiftit, sot partneri do të jetë në qendër të vëmendjes.

### GAFORJA

Gjatë mëngjesit do të jeni tërësisht të zhytur në punë, pastaj gjatë pasdites, me ndryshimin e Hënës, do të jetë partneri që do t'ju marrë të gjitha energjitë. Mbrëmjen do ta kaloni të qetë, pasi të keni mposhtur lodhjen me dashuri.

### LUANI

Do të keni ditë të mrekullueshme, përdërisa Hëna është në anën tuaj dhe më pas gjatë ditës do të bëjë që të jeni më entuziast dhe më të hareshëm. Shijojeni këtë të ditë sa më shumë të mundeni dhe mos e lini t'ju ike.

### VIRGJERESHA

Do të kaloni një ditë të hareshme me miqtë dhe do të keni bashkëpunim të ngushtë me kolegët. Do të jeni të sjellshëm dhe të edukuar me të gjithë që takoni sot. Ndërkaq, në mbrëmje do të ndjeni t'ju mbërthejë lodhja aq shumë, sa do t'ju zëri gjumi ndërsa shikoni një film.

### PESHORJA

Do të ndërmerrni projekte dhe investime të rëndësishme, por me kusht i që të kryhen në kohën e duhur, në të kundërt mund të mos arrini rezultatet e duhura. Veproni gjithmonë me logjikë, asnjë veprim i detyruar nuk të çon drejt suksesit.

### AKREPI

Gjatë gjithë mëngjesit do të jeni të ngarkuar me shumë projekte dhe do të bëni shumë punë, por pa arritur rezultatit e dëshiruar. Nga ana tjetër mbrëmja do të jetë e qetë, ndërsa Hëna nxit një miqësi që të kthehet në diçka më shumë.

### SHIGJETARI

Hëna mike në shenjën e juaj ju mbështet gjatë gjithë mëngjesit, duke bërë që të përqendrohni në komunikimin dhe fitim. Do të keni jetë sociale intensive dhe të përbushur. Me një axhendë kaq të mbushur me kontakte dhe takime, nuk mund të humbini asnjë minutë.

### BRICJAPI

Mëngjesi nis i zymtë, por humori do t'ju rikthehet gjatë pasdites nga Hëna, duke ua bërë pjesën tjetër të ditës më romantike. Me partnerin tuaj do të keni harmoni. Edhe këtë herë do të mbyllni një sy ndaj defekteve të vogla të partnerit.

### UJORI

Do të jeni në formë shumë të mirë, nën ndikimin e Hënës, Marsit e Uranit në shenjën tuaj. Çfarë është thënë, është bërë! Plot gjallëri dhe të fuqishëm gjatë ditës, por të rrasqitur në mbrëmje. Nuk është vetëm lodhje, ajo është edhe Hëna që ndryshon shenjë.

### PESHQIT

Mëngjesin do ta keni të zënë me punë, filme dhe shpenzime, por duke filluar nga orët e pasdites, me ndikimin e Hënës, çdo gjë do të ndryshojë në qiejllin tuaj të brendshëm. Do të kaloni një mbrëmje të këndshme me miqtë apo vetëm me partnerin.

**Sulmuesi do përfitojë 30 mln euro në sezon**

**Juve realizon goditjen e shekullit, blen Kristiano Ronaldo**

Pas zhurmës së madhe nuk ka më asnjë dyshim, Juventus realizon goditjen e shekullit, transferon në Torino as më shumë e as më pak, por Kristiano Ronaldo. Ajo që duket si një thashethem i radhës në këtë merkato të çmendur, tashmë është zyrtare. Reali dorëzohet përballë dëshirës së portugezëve për t'u larguar nga Madridi dhe ka qenë vetë klubi madrilen që ka bërë publike arritjen e marrëveshjes me Juven. "Los blankos" kanë

pranuar ofertën e Andrea Agnelli dhe për 105 milionë euro kanë lënë të lirë fenomenin portugez. Ronaldo pritet të firmosë një kontratë 4 vjeçare me bardhezinjtë, nga ku do të përfitojë 30 milionë euro neto në sezon. Ronaldo dhe Reali përsuan një krisje pas finale së Champions League, ku u kuptua qartë dëshira e tij për t'u larguar nga Spanja pas 9 vitesh, një shtet, i cili nuk pranoi kurrë pasurinë e padeklaruar të Ronaldos duke e detyruar të shkonin deri në gjyq. Ronaldo largohet nga

Real Madrid pasi arriti të fitojë gjithçka, 16 tituj në total ku sigurisht spikasin 4 Champions League. Me fanellën e Realit, Ronaldo luajti 438 ndeshje duke shënuar 451 gola. Me fanellën e bardhë Ronaldo, gjithashtu, arriti të fitojë 4 "Topa të artë", 2 herë çmimin "The Best" dhe shumë trofe të

tjerë. Sigurisht pas një karrierë të tillë, Ronaldo e konsideron të mbyllur ciklin me Realin, por fjalët e tij janë plot respekt për një klub ku së bashku arritën majat e Europës. "Këto vite te Reali i Madridit, dhe në këtë qytet, ishin ndoshta më të lumturat të jetës sime. Kam vetëm

vlerësim maksimal për këtë klub, dhe për këtë qytet. Ju falënderoj të gjithëve për dashurinë dhe afeksinon që kam marrë. Sidoqoftë, mendoj se është koha të hap një fazë të re në jetën time, dhe prandaj i kërkoja klubit të pranojë largimin tim. U kërkoj të gjithëve, në veçanti tifozëve të

më kuptojnë. Ata kanë qenë të mrekullueshëm për 9 vite. Kanë qenë 9 vite unike. Ish-te një moment emocional për mua, por edhe i vështirë sepse Reali i Madridit është një klub shumë kërkues. Kam reflektuar shumë dhe e di se ka ardhur koha për një cikël të ri. Po largohem, por kjo fanellë, kjo mburojë dhe "Santiago Bernabeu" do të vazhdojnë të ndjehen gjithmonë si të mija kudo që të jem. Faleminderit të gjithëve dhe natyrisht, siç thashë për herë të parë në stadiumin tonë 9 vite më parë: Hala Madrid!"

"Gjelat" e Dëshamp vuajnë, më pas rriten, shënojnë dhe administrojnë avantazhin e çmuar

**Franca në finalen e madhe Umtiti thyen Belgjikën!**

*"Djajtë e kuq" dorëzohen në gjysmëfinale*



Jeton Selimi

Franca kundër Belgjikës, ose Asteriksit kundër Obeliksit. Ashtu siç pritej ashtu edhe u luajt. Futboll shampanjë me dy skuadra njëkohësisht të hapura por edhe të kujdesshme, sidomos në pjesën e parë. Raste në të dyja portat, momente vendimtare nga gardianët apo mbrojtësit, që kanë shmanhur gola të sigurt për aq kohë sa mundën.

Pogba lëshon Mbapen në minutën e 12-të, por Kurtua e kupton dhe del shpejt për të ndaluar galopimin e 19-vjeçarit. Më pas shfaqen belgët, fillimisht me Hazar që nuk e gjen për fare pak kuadratin e Loris, ndërsa pak minuta më pas vetëm devijimi në castin e fundit nga Varane, shpëton Francën nga goli pas gjuajtjes së elitit belg. "Djajtë e kuq" po kalojnë momente të mira dhe i shkojnë shumë pranë golit me Alderveireld, që e gjen topin në këmbë dhe gjuan me shpinë nga porta, por fluturimi i Loris i mohan golin. Franca shkundet dhe nis të shohë nga kuadrati i Kurtuas. Provon fillimisht Zhirun pas kthesës me kokë, por gjuan për pak jashtë,



ndërsa Grizman shkarkon të djathtën, por për pak jashtë. Në minutën e 40-të "gjelat" kanë një mundësi fantastike shënimi pas zbritjes së Pa-

var, por Kurtua me këmbë devijon mrekullisht në këndore duke mbajtur portën të paprekur. Në fund të pjesës së parë Lukaku do të jetë i

pavëmendshëm pas harkimit nga e djathta, duke shpërdoruar një rast të mirë. Pjesa e parë mbyllet me rrjeta të paprekura, ndërsa e dyta

nis sërish me Lukakun, që me kokë gjuan jashtë. Por nëse Lukaku shpërdoron, Umtiti nuk e bën. Zhirun fiton një këndore pas gjuajtjes së devijuar dhe pas harkimit nga flamuri, mbrojtësi i Barcelonës kërcen saktë me kokë dhe thyen Kurtuan për golin e epërsisë së "gjelave". 1-0 dhe Belgjika e humbet disi toruan, pasi pak caste më pas Franca kishte një mundësi të dyfishtë shënimi, por fillimisht Matudi ndalen, ndërsa më pas Mbape shërben Zhirun me një numër prej fenomenit, por vetëm kaq. Belgjika nis të zgjohet, ndërsa Felaini me kokë i shkon fare pranë barazimit pas harkimit të Mertens. Franca ka luksin e kundërsulmit dhe në minutën e 67-të mund të kishte dyfishuar nëse Zhirun

do të finalizonte mirë, por sulmuesi i Celsi gjuan keq. Epërsia e një goli i jep qetësinë e duhur Francës për të administruar situatat, ndërsa Belgjika, nën presionin e rikuperimit, nuk arrin të shprehë potencialin e saj. Hazar kërkon të marrë vetë përsipër zhblokimin e situatës, por do të markohet rreptë nga blutë, gjithsesi Vitselit do t'i krijohet një mundësi të dyfishtë në të 81-ën, por që grushtohet nga Loris. Gjithsesi asgjë nuk do të ndryshojë deri në fund. Franca ruan me fanatizëm e duke luajtur me nervat e kundërshtarit golin që i siguron finalen e madhe, ndërsa Belgjika, edhe njëherë si në vitin 1986, dorëzohet në gjysmëfinale, që tashmë pret e qetë fituesen e çiftit Angli-Kroacia.

**Ndërsa Henderson kërkon përqendrim**

**Suthgejt: Kroacia është një top-team**



një top-team, që sikundër ne, janë të bindur se mund të arrijnë në finale".

Anglia ka kryer stërvitjen e fundit në prag të ndeshjes kundër ballkanasve dhe në ekip është stërvitur normalisht edhe Xhordan Henderson. "Besoj se jemi duke u përqendruar në atë që duam dhe atë që do të krijojmë. Kemi bërë mirë deri tani, por nuk do të ndalemi me kaq. Do t'i marrim të gjitha ndeshje pas ndeshje, sepse kështu kemi bërë gjithnjë. Nuk është e nevojshme ta bëjmë situatën më të madhe nga ç'është. Do bëjmë punën tonë dhe kaq".

**Lovren pret duelin me Herri Kejnin**

**Daliç: Një ndeshje e madhe, ta shijojmë**




ndeshje shumë e rëndësishme, por pavarësisht kësaj duam ta shijojmë".

Mbrojtësi i Kroacisë, Dejan Lovren, beson se ndaj Anglisë është ndeshja e jetës, teksa ka theksuar se përballja me Herri Kejnin do të jetë vërtet interesante. "E dimë se çfarë duhet të bëjmë që të kemi sukses. Në momente si këto e harron lodhjen dhe nuk dëshiron të dish sesa i lodhur je. Shansi për të luajtur një finale mund të të vijë një herë në jetë. Përballja me Kejnin? Ai është një kundërshtar i rrezikshëm, por pavarësisht kësaj do të jetë një duel interesant".

Anglia dhe Kroacia do të përballen mes tyre në një ndeshje që premon spektakël. Ishullorët janë pushtuar nga "suthgejt mania" me trajnerin e "tre luanëve" që ka fituar zemrat e patriotëve të tij me punën që ka bërë me Anglinë. Gjithsesi, për sfidën ndaj Kroacisë, Suthgejt ka thënë se do të jetë e vështirë pasi do të përballen me një top-team. "Kanë disa lojtarë vërtet të mirë. Mesfusha në veçanti është nga më të mirat në botë. E dimë forcën e tyre si edhe krenarinë e tyre kombëtare. Në këtë pikë, ata janë si Suedia, kanë një identitet të fortë ekipor dhe duhet të përgatitemi sa më mirë për të marrë fitoren. Janë



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Mund të jetë e pasur me minerale.
7. Ascoli në tabela.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.
14. Janë felinë të agër.
16. Marubi i fotografisë.
18. Janë meduza.
19. Një anarkist i famshëm.
21. Smith filozof.
22. Susanna shkrittare italiane.
23. Shkurt për company.
24. Organizma Autonome Kombëtare.
27. Mbarojnë punime.
28. Ndezur në aparaturë.
29. Bëjnë arte me re.
30. Nduket për gjysmë.
31. Mbyllin fushatat
32. Luca bomber.
34. Emri i parë i Pabolini-t.

35. Një mund të jetë fetar.
37. Lidhen të parat.
38. Fundi i një faze.
39. Emri i Bismarck.
40. Kant e Diabolik.
42. Ze... në traget.
44. Erite Informacioni Rajonale.
45. Triolet e Trëndafili me kredi.
47. Rruga e Ferenc Molnar.
48. Në krye të notarëve.
50. Gjysmë tatimi.
51. Ushtrihet me cd felse.

**VERTIKAL**

1. Numër i shkurtër.
2. Britame Arkimedit.
3. Inicialet e Paganini-t.
4. Fundi i Turandot.
5. Eshhtë fjetore ushtarësh
6. Parker regjisor.
7. Kështu quhet që ushqim kundër intoksikimit.
8. Një birrë e jona.
9. Mund të jenë pëdurimi.
10. Festat pa fat
11. Qendër ditore
13. Janë nomadë.
15. Fillojnë atletikën.
16. Eshhtë brinjë në skuadër.
17. Sidney i Serpico.
18. Qe centauri që mësonte Akilin.
20. Në mes të një kanali.
25. Bëhet për zakon.
26. Tregon martesë.
27. Një super... për shopping.
33. Vala e stadiumit.
34. Fillojnë poshtë.
36. Një provë... inteligjence.
38. Vaçe e famshme e këngës tonë.
41. Fillojnë vallen.
42. Para es Salaam.
43. Linearë pa larë.
46. Nota e diapzonit.
47. Mbyllin një shtëpi.
49. I keni në dorë.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

1. Eshhtë skuadra e donatorëve
7. Mbyllin një turp.
9. Mund të jetë unik
11. Një i absurdit është i Samuel Beckett
14. Qyteti i përjetshëm.
15. Interpretin Sandokan.
17. I ka tek tenda.
18. Eshhtë këngëtar lirik
19. Arturo i Brecht.
20. John, i forti i Sylvester Stallone-s.
21. Françesku kantaurot.
22. Eshhtë religjion politeist.
25. Qerre pa qe.
26. Gjysmë alarmi.
27. Eshhtë shtypi i ZP.


30. Kush ka... ka zët.
31. Altini mesfushor.
32. Janë vajzat në atletikë.
34. Eshhtë shpend lagune.
36. Gjysmë thyesë.
37. Udhëhoqi Argonautët.
39. Mund të jenë fotografikë të tillë.
40. Fillojnë panikun.

**VERTIKAL**


1. Janë çnjerëzore.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Edi në krye të PS.
4. Eshhtë lloj papagalli.
5. Fund turni.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Para devils për lojtarët e Manchester United.
8. U shkrua nga Kadare
10. Conan ai i Schwarzenegger.
11. Pak titanike.
12. Arbeni pa çifte.
13. I ka tek treni.
15. Mund të jenë pushimi
16. Mund të prishej nga je... kleçkë.
18. Në krye të bashkisë.
20. Eshhtë kundërshtar në dashuri
23. Meta në krye të LSI.
24. I vidhet ustait.
27. Jeppet e Artë në Cannes.
28. Eshhtë pije e jona.
29. Kufizojnë kënde.
31. Fillojnë lehtë.
33. Eshhtë dritëshkurtri.
35. Eshhtë numri i... të parit.
38. Fillojnë nazet.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A	T			
P	E	K	A	P	A	L	T	I	E	N	E		
R	E	K	O	R	O	D	E	T	P	M	I	E	R
I	A	R	T	I	N	E	D	E	N	I	N	E	
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R	A	T		
B	A	N	A	P	I	S	H	E	I				
E	P	I	T	E	T	E	T	T	E	S	T		
M	I	N	A	T	N	A	I	M	A	R			
I	K	A	P	A	K	R	I	M	A	R			
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A	T			
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	I	
K	A	A	S	L	U	L	I	M	A	T	A		
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U	M	R		
L	A	T	A	B	N	O	A	E	F	I			
L	A	N	E	L	E	M	E	N	I	A	R	E	
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A	T			
M	I	N	I	M	A	L	A	L	E	N	O		
I	N	L	I	T	A	R	T	E	M	A			
E	S	E	N	I	N	E	R	I	E	R			
P	A	N	A	I	M	E	K	N	I				
E	T	N	I	E	M	I	N	E	M	A			
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A				
A	L	A	I	N	E	M	I	S	A	R	E		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOKU**

			6	8				
8					6		5	
	9	3			4			
2		4	9			1		
5	1	8		6			2	
		8	7					
4					3	2		
					9	4		
		7						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	3	6	4	8	7	2	5	9
4	2	7	5	1	9	6	3	8
5	8	9	2	3	6	1	4	7
6	5	1	8	7	2	3	9	4
7	9	2	3	4	1	5	8	6
8	4	3	6	9	5	7	1	2
9	6	4	7	5	3	8	2	1
2	1	5	9	6	8	4	7	3
3	7	8	1	2	4	9	6	5

*Argëtim filozofik*

- Të gjithë janë në gjëndje të nxjerrin përfundime, pak janë gjëndje të gjykojnë.
- Dhuratat e vogla ruajnë miqësinë. Të madhajat, dashurin.
- Të përbashkëta janë ato që bëjnë një marrëdhënie të këndshme, por dallimet e vogla janë ato që i japin interes.



*Thënie të mençura*

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	8	4	2	4		13	1		13	
18	3	1	4		18		3		17	13	1
8	1	10		10		10	1	3	1	6	8
6		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4
13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2	
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	18
17	2	4	5	12		2	14		17	5	3
8	1	7	6		3	1	10	1			
4	5	12			4	6	4	18	7	7	6
1	A	3	R	E	S		1	5		2	3
13	19		1	3		20	5	4	6	10	6
1	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T		C	
I	R	O	N		L				T	R	U	P	
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T				
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T			U	
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T			P	R
C	K	R	I	A	B	O	R		A	T	A		
S	L	O		I	L	P			R	A	U	L	
T	A	N	T	A	L	I			U	R	R	A	
U	S		R		E	K	I	P	I		T	E	
F	A	T	A	L		A	L	I	E	N	E	T	
E	T	A	P	A	T		K	A	T	E	T	I	

- Gjithmonë kur diçka vjen papritur në jetë!
- tuaj, ikën në të njëjtën mënyrë!!!
- Ndershmëria, kryesisht, është më pak
- fitimprurëse se sa pandershmëria.
- Eshhtë dhimshme për ti thënë
- "lamtumirë" një personi që nuk do të të
- braktiste kurrë ... por më e dhimshme.
- është ti kërkosht një personi të qëndrojtë
- duke e ditur se një ditë do të të
- braktisë!!!

